



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

RAPORT MONITORIMI 2021 - 2024



MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË NXITJES
SË BIZNESIT DHE ÇËSHTJEVE TË TREGTISË

DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NJËZES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 30.7.2021
“Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve,
2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit”



RAPORT MONITORIMI 2021-2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NJËZES SË BIZNESIT

LISTA E SHKURTIMEVE

AIDA	Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKKSHI	Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit
AKPA	Agjensia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
AKSHI	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
BDHTI	Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
ERP	Programi i Reformave Ekonomike
GNP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
IHD	Investime të Huaja Direkte
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NMVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
QFP	Qendra e Formimit Profesional
RSH	Republika e Shqipërisë
SZHBI	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve
TKP	Treguesit kryesorë të Performancës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

PËRMBAJTJA

I.	INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2021 – 2027, PËR PERIUDHËN 2021 – 2024.....	5
II.	REFORMA TË IMPLEMENTUARA ME SUKSES PËR PERIUDHËN 2021-2024, NË STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE.....	6
III.	IMPAKTI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË NË PËRPUTHJE ME AXHENDËN E INTEGRIMIT EUROPIAN.....	10
IV.	KOMPONENTËT QË KANË NEVOJË PËR ADRESIMIN ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E IMPLEMENTIMIT.....	11
V.	EKZEKUTIMI I PËRGJITHSHËM I BUXHETIT.....	11
VI.	VLERËSIMI SIPAS SECILIT OBJEKTIV DUKE PËRDORUR TREGUESIT.....	12

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2021 – 2027, PËR PERIUDHËN 2021 – 2024

Bazuar në një qasje koherente dhe të zbatueshme, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe investimet. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me mbështetjen e GIZ Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - hartoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për periudhën 2021-2027, e cila reflektoi rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin për Shqipërinë për vitin 2020¹.

Strategjia u përgatit bazuar në konsultime intensive me palët e interesit dhe ekspertët e sektorit publik dhe privat. Vizioni i strategjisë është “Një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin Evropian dhe atë rajonal”.

Ky vizion është zbërthyer në një qëllim të politikave: “Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integritit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës”.

Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera fokusohen në këto tre objektiva specifike:

OBJEKTIVI SPECIFIK I.1 Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi. Shpалosja e plotë e potencialit investues për zhvillim ekonomik dhe nxitja e integritit në tregjet dhe zinxhirin e vlerave ndërkombëtare.

OBJEKTIVI SPECIFIK I.2 Zhvillimi i NMVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni. Zhvillimi i një ekosistemi dinamik dhe të qëndrueshëm për sipërmarrjen dhe inovacionin.

OBJEKTIVI SPECIFIK I.3 Zhvillimi i kapitalit njerëzor. Eksplorimi i mënyrave të reja për të nxitur zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve zbatohet në periudhën 2021-2027. MEKI është institucioni përgjegjës për fushën e biznesit dhe investimeve si edhe lider për zbatimin e SBZHI. Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë është përcaktuar me planin e veprimit dhe ndahet midis MEKI-t, institucioneve të varësisë, pushtetit vendor dhe aktorëve të tjerë. Kostoja indikative për zbatimin e Strategjisë është 9,605,535,640 lekë.

Në zbatim të pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 30.7.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit”, është përcaktuar ngritja e grupit ndërinstitucional për monitorimin e Strategjisë, në drejtimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Bazuar në Urdhërin e KM nr. 214, datë 13.12.203 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të planit të saj të veprimit”, Grupi i punës ka për detyrë;

- Monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të aktiviteteve dhe masave të Planit të Veprimit të SZHBI 2021-2027, në përputhje me guidën metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes;
- Raportimin mbi ecurinë e indikatorëve dhe objektivave të pasaportës së performancës të strategjisë;

1. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NJËZITËS SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

II. REFORMA TË IMPLEMENTUARA ME SUKSES PËR PERIUDHËN 2021-2024, NË STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE.

1. Fushata “Outreach Campaign”. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka realizuar disa fushata “Outreach Campaign”²: në sektorin e bujqësisë në Stamboll, Turqi, në sektorin e manifakturës në Gjermani, në sektorin e turizmit në Spanjë. Aktualisht AIDA po planifikon zhvillimin e dy fushatave të tjera outreach në vitin 2025 në sektorin ICT/BPO dhe në sektorin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, në bashkëpunim me TEDA Tirana shpk.

2. Asistencë, ndërmjetësim dhe adresim i interesave të kompanive të huaja. Janë zhvilluar gjithsej 106 aktivitete nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në kuadër të ofrimit të asistencës, ndërmjetësimit, adresimit të interesave të kompanive të huaja për investim/partner/biznes/treg.

3. Shërbimi “Aftercare” dhe intensifikimi i shërbimeve “aftercare”³ nga AIDA. Ky shërbim konsiston në ofrimin e asistencës administrative, operacionale dhe strategjike. Shërbimi Aftercare është i njohur si një mjet efektiv sa i përket përfshirjes së ndërmarrjeve në ekonominë lokale dhe rritjes së përfitimeve të tyre. AIDA ndërmerr iniciativë si takimet në terren, organizimi i tryezave të rrumbullakëta apo asistencë e dedikuar ndaj kompanive të vendosura në Shqipëri, për problematika të ndryshme që mund të hasen gjatë implementimit të planit të biznesit, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit dhe inkurajimin e riinvestimeve nga këto subjekte. Për periudhën 2021-2024 janë zhvilluar gjithsej 235 takime. Në fillim të vitit 2024, AIDA zgjeroi bashkëpunimin me bashkitë duke nënshkruar një MoU me bashkinë Korçë, duke e bërë bashkinë e 12-të, me të cilën AIDA bashkëpunon dhe koordinohet sa i përket përkujdesjes ndaj investitorëve.

4. Shërbimi “E-commerce”. Zbatimi i masave për ngritjen e kapaciteteve për “e-commerce”. Grupi i punës për zhvillimin e nismës “Zhvillimi i Tregtisë Elektronike”, me anëtarë përfaqësues edhe nga AIDA, në bashkëpunim me Bankën Botërore, hartoi, publikoi dhe prezantoi Guidën “Si të nisësh një biznes e-commerce”, pyetësorin “Self-Assessment Tool”, si dhe një seri trajnimesh të dedikuara posaçërisht kësaj nisme gjatë vitit 2022. <https://aida.gov.al/e-commerce.pdf>.

- Në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (AITA) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), AIDA organizoi një sërë trajnimesh me fokus tregtinë elektronike për SME-të shqiptare. Trajnimi përfshinte materiale teorike dhe ushtrime praktike (Qershor-Korrik 2022).

- AIDA organizoi një seminar trajnimi të fokusuar në tregtinë elektronike në bashkëpunim me Qendrën e Aleancës Gjinore për Zhvillim (GADC), me mbështetjen e Gender Equity and Equality Action (GEEA). Ky trajnim targetonte gra artizane dhe gra që punojnë në sektorin e turizmit dhe hotelierisë që synojnë të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre për të krijuar dhe menaxhuar një kanal e-commerce për biznesin e tyre.

- Gjithashtu është miratuar Urdhri i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 397 datë 10.06.2024 “Për Miratimin e Strukturës së Planit të Veprimit për Tregtinë Elektronike 2024-2027”. Plani i Veprimit është i ndarë sipas seksioneve të mëposhtme:

- Organizimi i Tregtisë Elektronike
- Forcimi i Tregtisë Elektronike
- Besueshmëria dhe Tregtia Elektronike
- Çështjet ndërsektoriale
- Statistikat e Tregtisë Elektronike
- Informaliteti dhe Tregtia Elektronike

2. “Outreach Campaign” është një program mbështetje strategjike për të krijuar lidhje dhe për të ndërtuar marrëdhënie me një grup të synuar, me qëllim rritjen e vizibilitetit, ndërtimin e besimit dhe promovimin e një produkti/shërbimi.

3. “Aftercare” është shërbimi i përkujdesjes ndaj investitorëve të huaj dhe vendas prezentë në vendin tonë.

5. Krijimi dhe funksionimi i Agjencisë së Start-upeve. Agjencia “Startup Albania” është themeluar në Dhjetor 2023, si një agjenci shtetërore në varësi të Ministrisë së Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit. Misioni i “Startup Albania” është të sigurojë mirëfunksionimin e ekosistemit të startup-eve zhvillimin e sipërmarrjes inovative nëpërmjet mbështetjes dhe zhvillimit të saj. Në total numri i startup-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik dhe të pajisur me pasaportën përkatëse që menaxhohet nga Agjencia “Startup Albania” është rreth 2100.

6. Fuqizimi i ekosistemit të “start-upeve”. Nëpërmjet projektit “EU for Innovation” po zhvillohen kapacitetet (Capacity building) për ekosistemin e start-up dhe inovacionit. Aktorët e rinj publikë dhe privatë po mbështeten të hyjnë në ekosistemin e start-up-eve dhe inovacionit shqiptar për të rritur cilësinë e shërbimeve.

7. Programi për financimin e projekteve të teknologjisë dhe inovacionit (PTI). Ky program u mundësua nga AKKSHI për herë të parë në vitin 2023. Programi i dedikohet financimit të projekteve që vijnë si bashkëpunim mes universiteteve dhe biznesit, në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”.

8. Ligji i ri për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit Nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, i cili parashikon vendosjen dhe zbatimin e përkufizimit ligjor për NMVM-t, vendosjen e formave të mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, vendosjen e rregullave për hartimin e skemës së garancive shtetërore të huasë, ofrimin e shërbimit publik nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve etj. Në Dhjetor 2024 u organizua mbledhja e parë e Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet (KKN). KKN ka për qëllim të ofrojë një platformë të rëndësishme për dialogun mes sektorit publik dhe atij privat. Lançimi i KKN-së përfaqësoi një moment të rëndësishëm sa i përket përmirësimit të kushteve të të bërit biznes dhe mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). KKN përbëhet nga 11 anëtarë nga institucionet shtetërore, institucionet e arsimit të lartë, shoqatat e biznesit etj dhe kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

9. Koordinimi i programit të aftësive sipërmarrëse për NMVM-të. Në vitin 2021 AIDA ka qenë partnere në projektin “Sfida IDEA” duke asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, që prej promovimit, vlerësimit të planeve të biznesit dhe shpalljen e finalistëve. Në vitin 2022, AIDA ka qenë partnere në projektin “Beyond IDEA” duke asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, nga promovimi, te vlerësimi i planeve të biznesit dhe shpallja e finalistëve. Në vitin 2023, AIDA si pika kryesore e të gjitha aktiviteteve që do të zhvillohen në Shqipëri në kuadër të projektit “Skills for Sustainable Employment and Inclusive Economic Growth of Cross-Border Region of Albania and Montenegro–Skills for Jobs Albania–Montenegro” të financuar nga Bashkimi Europian nëpërmjet programit “Cross-Border Cooperation Programme Montenegro –Albania 2014-2020, nëpërmjet Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II)” ka organizuar thirrjet për trajnim dhe mentorim punëdhënës të rinj, si më poshtë:

1. Thirrje për aplikime për NMVM-të dhe punëdhënës që janë të interesuar të ofrojnë trajnime në punë (on-job training) pranë ambienteve të tyre për të aftësuar të rinj (15-29 vjeç) dhe gra të papuna në sektorët hoteleri-turizëm, gastronomi, artizanat, ICT dhe sektorë të tjerë të ndërlidhur.

2. Thirrje për aplikime për të rinjtë (mosha 15-29 vjeç) dhe gratë, të papunë që jetojnë në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe për të përfutur trajnime në punë (on-job training) (Thirrja 1). Në përfundim të aplikimeve, u përzgjodhën 15 mentorë të 15 subjekteve tregtare (NMVM) nga sektori artizanat, hoteleri-turizëm dhe ITC, dhe 15 të rinj dhe gra të papuna të cilët u trajnuan në këto subjekte për një periudhë 3 muaj duke filluar nga muaji shtator 2023. Gjatë kësaj periudhe, mentorët kanë përfutur një vlerë prej 200 euro në muaj ndërsa të rinjtë një vlerë prej 450 euro në muaj.

3. Thirrje për aplikim për ofrimin e kurseve të trajnimit profesional për udhërrëfyes turistik kombëtar për një grup prej 5 (pesë) individësh (të rinj ose gra të papuna), për periudhën maksimale deri në 4 muaj”.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

4. Thirrje për aplikime për të gjithë të rinjtë të grupmoshës 15-29 vjeç dhe gra të papuna, për të qenë pjesë e trajnimeve për udhërrëfyes turistik profesional kombëtar në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe.

Në përfundim të aplikimeve, u përzgjedh si fitues shoqëria “Pegasos Travel” sh.p.k. dhe 5 individë, të cilët u trajnuan për një periudhë 4-mujore duke filluar nga muaji shkurt 2024. Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën me certifikata “Kurs për udhërrëfyes turistik, kategoria kombëtar”, 600 kredite. Gjatë kësaj periudhe të rinjtë përfituan një vlerë prej 450 euro në muaj.

5. Thirrje për aplikime “Për përzgjedhjen e mentorëve për ofrimin e shërbimit të trajnimit me qëllim aftësimin e të rinjve (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna për krijimin e planeve të biznesit dhe fillimin e një biznesi, në Bashkitë Shkodër, Vaut i Dejës dhe Malësi e Madhe.

6. Thirrje për aplikime “Për ofrimin e shërbimit të mentorimit për aksesin në financë dhe simulim në paraqitjen e ideve të biznesit.

7. Thirrje për aplikime “Për të qenë pjesë e trajnime për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse, për 15 pjesëmarrës të rinj (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Në përfundim të aplikimeve, u përzgjedhën 7 mentorë dhe 11 të rinj për të qenë pjesëmarrës në trajnime në fushat si:

- Aspekte ligjore dhe regjistrimi i biznesit
- Menaxhimi financiar dhe kontabiliteti
- Planifikimi strategjik dhe krijimi i modelit të biznesit
- Marketingu dhe shitjet
- Marketing dixhital/ përmbajtje
- Aksesin në financë
- Simulim në paraqitjen e ideve të biznesit

Trajnimet u zhvilluan në formën teorike dhe praktike, për periudhën prill-qershor 2024. Gjatë kësaj periudhe mentorët përfituan një pagesë në vlerë 600 euro për pjesën teorike dhe 100 euro për çdo pjesëmarrës për pjesën praktike. Në përfundim të këtyre trajnimeve nga të rinjtë pjesëmarrës u përzgjedhën 5 të rinj, të cilët prezantuan plane biznesi si më të vlerësuara për fillimin e një biznesi duke përfituar si çmim një shumë në vlerën 3000 euro për mbulimin e shpenzimeve të regjistrimit të biznesit, blerjes së pajisjeve të nevojshme dhe/ose shërbimeve konsultante.

8. Realizimi i një video-dokumentari, që dokumenton zhvillimin dhe prezantimin e ideve dhe plan bizneset, të zhvilluar nga 7 mentorë të kontraktuar nga AIDA për ofrimin e shërbimit të trajnimit, zhvillim të ideve dhe modeleve të biznesit nga ana e pjesëmarrësve në trajnim, si dhe përgatitjes dhe prezantimit të ideve të biznesi të zhvilluara në periudhën prill-qershor 2024. Gjithashtu, është bërë i mundur përkthimi i video-dokumentarit me titra në anglisht.

9. Pjesëmarrje e stafit të projektit së bashku me 10 kompani nga Bashkia Shkodër dhe Vau i Dejës, të sektorit të turizmit dhe artizanatit, në panairin e Biznesit në datat 22-23 tetor 2024, në Budva, Mal i Zi, organizuar në bashkëpunim me Dhomën e Ekonomisë të Malit të Zi dhe Fondacionit Business Start Center Bar (Mali i Zi).

10. Kryerja e rregullt e VNT nga AIDA. Në kuadër të mbështetjes së NMVM shqiptare, AIDA vlerëson periodikisht nevojat e tyre për trajnim nëpërmjet pyetësorëve të publikuar në rrjetet e komunikimit për një periudhë një-mujore. Mesatarisht, pyetësori plotësohet çdo vit nga 100 – 150 NMVM vendase, përgjigjet e të cilave lejojnë AIDA-n të kryejë një analizë statistikore të nevojave për trajnim. AIDA gjithashtu vlerëson në mënyrë të vazhdueshme nevojat për trajnim të stafit, të cilat konsistojnë kryesisht në ngritje kapacitetesh për ekspertizë të ndryshme. Gjatë vitit 2023, stafi i Drejtorisë NMVM & Projekte, dhe stafi i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim – Analizë u trajnuan me mbështetjen e GIZ për ngritjen e kapaciteteve për kërkim tregu për qëllime eksporti, si dhe mbi organizimin e “workshop”-eve për subjektet eksportuese.

Pyetësor lidhur me identifikimin e panairove ndërkombëtare:

- <https://aida.gov.al/aida-fton-te-gjitha-sipermarrjet-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-nmvm-qe-operojne-ne-sektorin-e-tekstileve-te-plotesojne-pyetesorin-per-identifikimin-dhe-pezgjedhjen-e-panairove-nderkombetare-me-int/>
- <https://aida.gov.al/aida-fton-te-gjitha-sipermarrjet-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-nmvm-qe-operojne-ne-sektorin-e-lekure-kepuces-te-plotesojne-pyetesorin-per-identifikimin-dhe-pezgjedhjen-e-panairove-nderkombetare-me/>
- <https://aida.gov.al/aida-fton-te-gjitha-sipermarrjet-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-nmvm-qe-operojne-ne-sektorin-e-it-te-plotesojne-pyetesorin-per-identifikimin-dhe-pezgjedhjen-e-panairove-nderkombetare-me-interes-te/>
- <https://aida.gov.al/aida-fton-te-gjitha-sipermarrjet-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-nmvm-qe-operojne-ne-sektorin-e-agroperpunimit-te-plotesojne-pyetesorin-per-identifikimin-dhe-pezgjedhjen-e-panairove-nderkombetare-me/>
- <https://aida.gov.al/aida-fton-te-gjitha-sipermarrjet-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-nmvm-qe-operojne-ne-sektorin-e-bujqesise-te-plotesojne-pyetesorin-per-identifikimin-dhe-pezgjedhjen-e-panairove-nderkombetare-me-inte/>
- Pyetësor mbi identifikimin e nevojave për shërbimet e reja të NVMV-ve: <https://aida.gov.al/pyetesor-mbi-identifikimin-e-nevojave-per-sherbime-te-reja-te-ndermarrjeve-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme/>
- Pyetësor mbi nevojat për financim të NVMV-ve: <https://aida.gov.al/aida-ju-fton-te-plotesoni-pyetesorin-mbi-identifikimin-e-nevojave-per-financim-me-grant-nga-buxheti-shtetit-per-ndermarrjet-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-nmvm/>
- Pyetësor mbi identifikimin e nevojave dhe kërkesave të grave sipërmarrëse: <https://aida.gov.al/pyetesor-mbi-identifikimin-e-nevojave-dhe-kerkesave-te-grave-sipermarrese/>
- Pyetësor mbi identifikimin e nevojave për trajnim të NVMV-ve: <https://aida.gov.al/pyetesor-per-identifikimin-e-nevojave-per-trajnim-te-ndermarrjeve-mikro-te-vogla-dhe-te-mesme-shqiptare-nmvm/>
- **Enterprise Europe Network Albania (EEN-Albania).** Në vijim të përfshirjes së AIDA në projektet ndërkombëtare, AIDA është aktualisht koordinatore e projektit “Enterprise Europe Network Albania” (EEN-Albania), një iniciativë e financuar nga Bashkimi Europian në kuadër të programit SMP-COSME. Ky projekt synon rritjen e konkurrueshmërisë dhe ndërkombëtarizimin e NMVM-ve shqiptare përmes ofrimit të shërbimeve të avancuara të biznesit, përfshirjes në rrjete ndërkombëtare dhe krijimit të mundësive për zhvillim të qëndrueshëm. EEN-Albania është një platformë kyçe për mbështetjen e sipërmarrësve shqiptarë drejt tregjeve globale.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËJ BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

III. IMPAKTI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË NË PËRPUTHJE ME AX-HENDËN E INTEGRIMIT EUROPIAN

“SZHBI 2021 – 2027” lidhet me kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale” të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian. Politikat e BE-së për ndërmarrjet dhe industrinë kërkojnë të promovojnë strategjitë industriale që rrisin konkurrencën duke përsheptuar përshtatjen ndaj ndryshimeve strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në, si dhe investimet e brendshme dhe të huaja. Ato gjithashtu synojnë të përmirësojnë mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin veprojnë NMVM-të.

Growth Plan : Koordinimi dhe përfshirja në procesin e hartimit të masave të planifikuara në Agjendën Kombëtare të Reformave për Shqipërinë në kuadër të Growth Plan 2024-2027. (miratuar me VKM Vendi-min e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 dhe botuar në fletoren zyrtare nr.198).

Prioritetet kryesore të Reformave për Agjendën Kombëtare të Reformave 2024-2027 janë organizuar sipas 5 shtyllave (Klima e Biznesit, Kapitali Njerëzor, Aftësitë Digjitale, Energjia dhe Tranzicioni i Gjellbër, Themeloret /Shteti i së Drejtës) ku në total janë 30 reforma dhe 139 masa nga të cilat nën përgjegjësinë e MEKI janë 12 reforma dhe 64 masa.

MEKI ka në prioritet fuqizimin e kuadrit ligjor dhe institucional në lidhje me zhvillimin e biznesit dhe investimeve, duke synuar njëkohësisht dhe harmonizimin e këtij kuadri ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, duke mbajtur në konsideratë veçanërisht dy dokumente udhëheqëse: 1) Akti i biznesit të vogël për Evropën (KE 2008) dhe 2) Strategjinë e NMVM-ve për një Evropë të qëndrueshme dhe dixhitale (KE 10 Mars 2020).

Një ndër objektivat kryesore të AKR 2024-2027 është konsolidimi i reformave që mundësojnë e mbështesin transformimin e mëtejshëm të Shqipërisë në një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e drejtuar nga qeverisje ekonomike transparente, infrastruktura ekonomike efikase dhe një kuadër ligjor i favorshëm për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e eksporteve, që përputhet me acquis dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.

Ky objektivi përfshin disa iniciativa kryesore, të parashikuara si masa në dokumentin e politikës AKR 2024- 2027, që nxisin një klimë biznesi edhe më konkurruese dhe tërheqëse, përmes një kornize kohezive dhe mbështetëse për zhvillimin ekonomik, përmes reformave dhe masave si:

- **Rritja e tërheqjes dhe transparencës së investimeve, në përputhje me praktikën e BE-së, përmirësimi i qeverisjes së shoqërive në pronësi shtetërore dhe Ndihmës Shtetërore.**
- Miratimi i bazës ligjore për të siguruar një Autoritet me pavarësi operacionale të Ndihmës Shtetërore dhe i masave operacionale përkatëse (buxheti) (me afat Dhjetor 2025).
- **Përmirësimi i kornizës së tërheqjes së investimeve dhe në veçanti i kuadrit të IHD-ve dhe i mjedisit të biznesit nëpërmjet derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve të biznesit.**
- Miratimi i ligjit (eve) të unifikuar të investimeve dhe akteve kryesore nënligjore për zbatimin e ligjit, në përputhje me praktikën më të mira të BE-së (Dhjetor 2026).
- Miratimi i një plani veprimi për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Indeksin e OECD-së për Politikën e SME-ve (Dhjetor 2025).
- **Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje.**
- Miratimi i Programit për Nxjitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (Dhjetor 2025).
- Progresi i arritur në iniciativat rregullatore (Dhjetor 2025/Qershor 2026) dhe/ose masat mbështetëse në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian (Dhjetor 2027).
- Rritja e peshës së eksporteve (shërbime dhe mallra) ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB, ku pesha e eksporteve ndaj PBB-së është në vlerë neto 40% (Qershor 2027).

IV. KOMPONENTËT QË KANË NEVOJË PËR ADRESIMIN ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E IMPLEMENTIMIT

Me qëllim përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2021 - 2027, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë mungesa e pronave dhe projekteve konkrete për t'u prezantuar investitorëve potencialë, pasi AIDA nuk i ka këto mjete që të targetojë investitorë.

V. EKZEKUTIMI I PËRGJITHSHËM I BUXHETIT

Kostimi i Strategjisë është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e kostos shtesë për zbatimin e Strategjisë dhe hendekut financiar në raport me fondet buxhetore të planifikuara në PBA 2021-2023, në Programin Buxhetor 04130 "Mbështetje për zhvillim ekonomik", dhe nga financimi i donatorëve. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse. Kostot buxhetore të Strategjisë janë të planifikuara në Programin Buxhetor 04130 "Mbështetje për zhvillim ekonomik", në të cilin përfshihet edhe institucioni i AIDA-s për implementimin e aktiviteteve përkatëse të Strategjisë.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e SBZHI 2021 - 2027 është **9,605,535,640 Lekë**, ose **78,093,786 Euro**⁴. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 7 viteve të zbatimit të SZHBI 2021 - 2027.

Qëllimi i Politikës	Tipologjia e kostos	Kostoja Totale 2021-2027	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2027 Buxheti dhe Donatorët	Hendeku Financiar 2021-2037
P1 Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.	Korente	9,605,251,360	8,914,680,908	690,570,452
	Kapitale	284,280	284,280	
TOTALI [Lekë]		9,605,535,640	8,914,965,188	690,570,452
TOTALI [Euro]		78,093,786	72,479,392	5,614,394
1 euro 123 Lekë				

Financimi i planit të veprimit të zbatimit të kësaj strategjie do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondet e NJVV dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2021-2027, buxheti i shtetit pritët të financojë zbatimin e planit në masën 71 % të financimit të nevojshëm, 22 % pritët të financohet nga donator të huaj, ndërsa 7 % është hendek financiar.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2021 - 2024, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi aktivitetet e kryera. Nga monitorimi i BIDS për periudhën 2021-2027 rezultojnë të planifikuara në total 1,349,006,304 lekë. Për masat e realizuara ishin parashikuar 1,025,177,174 lekë (nga këto 144,700,070 lekë nga buxheti i shtetit, 878,667,600 lekë nga donatorët dhe 1,809,504 lekë me hendek financiar), për masat në zbatim 257,160,000 lekë (nga këto 120,000 lekë nga buxheti i shtetit dhe 257,040,000 lekë hendek financiar), dhe për masat e pazbatuara 66,669,130 lekë (nga këto 45,069,130 nga buxheti i shtetit dhe 21,600,000 lekë me hendek financiar).

4. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 123 lek për 1 euro



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

VI. VLERËSIMI SIPAS SECILIT OBJEKTIV DUKE PËRDORUR TREGUESIT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe pasqyron grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën 2021-2024.

Rezulton se nga 36 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 21 prej tyre, janë ende në proces zbatimi 5 prej tyre dhe të pazbatuara 10 prej tyre. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit 2021 - 2027 është në nivelin 72.71 % për aktivitetet të të realizuara dhe në proces (58.33 % për aktivitetet e zbatuara dhe 13.88 % për aktivitetet në proces) dhe 27.29 % për aktivitetet e parealizuar.

1. Objektivi specifik 1.1: “Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi”

1.1.1 Masa “Promovimi /lehtësimi sistematik i investimeve të synuara”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe shoqatat e biznesit.

Progresi në zbatimin:

Nga ana e AIDA-s është punuar për planifikimin dhe zbatimin e aktivitete për promovimin dhe lehtësimin e investimeve.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.1.1.1 : “Zbatimi i fushatave informuese specifike për grupet e synuara (investime me mjetet e nevojshme të IT-së)”

Aktivitete të zhvilluara nga AIDA

- **Viti 2022:** Përgjatë vitit 2022, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), realizoi fushatën “Outreach Campaign” në sektorin e bujqësisë në Stamboll, Turqi. Fokusi i kësaj fushate ishin kontaktimi dhe prezantimi i mundësive për investim në Shqipëri për kompanitë turke, të cilat operojnë në prodhimin dhe përpunimin e domateve, frutave dhe bimëve aromatike dhe medicinale. “Outreach Campaign” është një program mbështetje strategjike për të krijuar lidhje dhe për të ndërtuar marrëdhënie me një grup të synuar, me qëllim rritjen e vizibilitetit, ndërtimin e besimit dhe promovimin e një produkti, ose shërbimi. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka realizuar disa fushata “Outreach Campaign” si në sektorin e bujqësisë në Stamboll, Turqi, në sektorin e manifakturës në Gjermani, dhe në sektorin e turizmit në Spanjë. Aktualisht AIDA po planifikon zhvillimin e dy fushatave të tjera outreach në vitin 2025 në sektorin ICT/BPO dhe në sektorin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, në bashkëpunim me TEDA Tirana shpk.
- **Viti 2023:** Në Prill 2023, AIDA mori pjesë në panelin e Konferencës së Investimeve të Dhomave të Ballkanit Perëndimor, e organizuar si një aktivitet gjatë mbajtjes së panairit “Hanover Messe 2023”. Konferenca shërbeu për dhënie informacione mbi kuadrin e investimeve, duke përfshirë përfitimet dhe mundësitë e të bërit biznes në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por gjithashtu mundësoi shfaqjen e shembujve të investimeve të suksesshme në rajon.
- **Viti 2024:** Përgjatë muajit qershor 2024, AIDA me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe World Bank Group (WBG) zhvilloi një fushatë “outreach” me fokus sektorin e turizmit në Spanjë. Në kuadër të tërheqjes së brande-ve elitare europiane në tregun vendas, AIDA zhvilloi takime fizike me disa prej grupeve hoteliere më të njohura spanjolle, duke përfshirë Barcelo Group, Catalonia Hotels dhe Eurostar Hotels by Groupo Hotusa për të prezantuar ofertën e qeverisë shqiptare, incentivat fiskale të sektorit të turizmit, avantazhet konkurruese të Shqipërisë etj.

Gjatë takimeve u konstatua një interes i lartë për t'u bërë pjesë e tregut shqiptar dhe se vëmendja e grupeve hoteliere më të mëdha spanjolle është të zhvillojnë struktura elitare në bregdetin shqiptar, por pa përjashtuar dhe vendosjen në qytetet më të mëdha në vend që ofrojnë turizëm 12-mujor si Tirana, Durrësi, Vlora etj.

Në përfundim të këtyre takimeve, AIDA zhvilloi gjithashtu një takim me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Madrid dhe me Dhomën e Ekonomisë Shqiptari -Spanjë ku krahas diskutimeve mbi interesin e shtuar drejt Shqipërisë si një destinacion për të investuar në sektorin e turizmit dhe jo vetëm, u vlerësua dhe nevoja për një koordinim të shtuar dhe sa më eficient të aktorëve publik dhe privatë në funksion të realizimit të objektivit të përbashkët të fuqizimit të ekonomisë shqiptare.

Në muajin tetor 2024, përfaqësuesi i Eurostar Hotels vizitoi Shqipërinë si edhe realizoi një takim pranë zyrave të AIDA-s.

Aktivitete të realizuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Asistencë/ndërmjetësim/adresim të interesave të kompanive të huaja për investim/ partner/biznes/treg:

1. Arabi Saudite: Negociohet me AIDA-n lidhur me një projekt-propozim për investim të grupit të investitorëve Q-invest. Grup investitorësh të fushës së biznesit por edhe fushave të tjera, që kanë realizuar disa investime në Katar dhe Turqi, në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë. Kosto paraprake e investimit parashikohet në rreth 30 milionë USD
2. Azerbajxhan- kërkesë për takim mes përfaqësuesve të MIE-s dhe palës azere mbi Rafinerinë e Ballshit;
3. Bullgari- Interesi i kompanisë Techno-Trailers Ltd, e cila është përgjegjëse për zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit me prodhuesit evropianë Saf-Holand (www.saf-holland.com) për territoret e Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Produktet e kompanisë konsistojnë në produkte për mjete motorike, lubrifikantë dhe aplikacione shërbimesh. Më shumë rreth produkteve të kompanisë gjeni në linkun <http://www.safholland.bg/bg/en/> ;
4. Bullgari- Kompania ALD-Import Ltd interes për bashkëpunim me kompani shqiptare në sektorin e produkteve mjekësore. Kompania është themeluar në vitin 2009 dhe merret me importimin dhe shitjen e produkteve si: doreza mjekësore dhe pajisjeve mbrojtëse;
5. Bullgari- Vizitë në Shqipëri e Presidentes dhe përfaqësueses nga Bullgaria të Alter Ego Company, znj. Kalinka Kovatcheva 16-20 maj 2021. Takime me përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, ekspertë dhe zyrtarë përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe modernizimin për të diskutuar rreth mundësive potenciale të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes;
6. EBA- Video-konferencë mes AIDA-s dhe përfaqësuesit e kompanisë;
7. Egjipt- Interesin e kompanisë “Egypt Fish for Industries Food” për eksport në Shqipëri;
8. Greqi- Përcjelljen e të dhënave të Autoritetit përgjegjës për farmako-vigjilencën dhe pikave të kontaktit të tyre me qëllim asistimin e Ambasadës së RSH-së në Athinë dhe kompanisë “ECOLAB”;
9. Hungari- Kompania hungareze e konsulencës East-west Connect Consulting, të interesuar për përpunimin e mbetjeve urbane në Shqipëri me incenerator;
10. Hungari- Kërkesa e kompanisë hungareze “4iG” për takim me Ministren znj. Balluku, në kuadër të ndryshimit të pronësisë së kompanisë “Albtelekom”;
11. Hungari- Kompania hungareze Adencosmetics, Hungari, kërkon të vendosë lidhje partneriteti biznesi me kompani shqiptare në Shqipëri;
12. Hungari- Kërkesë për leje e Agjencisë hungareze TS Tours për vendosjen e autobusëve charter Hungari-Shqipëri;
13. Hungari- Kërkesat e kompanisë hungarezo-italiane mbi sektorin e përpunimit të mbetjeve;
14. Hungari- Interesi i kompanisë hungareze Gemtech për një park solar fotovoltai 10 MË në Shqipëri dhe kërkesa për një sipërfaqe 20 ha;
15. Izrael- Mbi interesin për bashkëpunim të ardhur nga kompania izraelite “Arrow Operations Technologies”;



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËJ BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

16. Izrael- Roots Company kërkon bashkëpunim me kompanitë shqiptare që operojnë në tregun e agro-bujqësisë, në sektorin e 'Green House';
17. Izrael- Kërkesa për informacion e kompanisë farmaceutike izraelite "Farmalagacy" për eksportin e kapsulës CVO+;
18. Izrael- Kompania "Taga Urbanik";
19. Izrael- Kompania e tekstit "Sonovia", me anë të një letre shpreh interesin për hyrjen në tregun shqiptar, shpërndarjen dhe shitjen e maskave mbrojtëse me efikasitet 99% për neutralizimin e viruseve përfshirë edhe Sars-Cov-2.;
20. Izrael- Kompania "Arrow Operations and Technologies" -Kërkon për të bashkëpunuar me një partner/kompani shqiptarë që operon në të njëjtën fushë specializimi;
21. Izrael- Adresuar tek AIDA interesi i kompanisë izraelite "Taga Urbanic" për të investuar në Shqipëri;
22. Izrael- "Top GreenHouse"- propozimin e kompanisë izraelite "Top GreenHouse" për investimin e një Greenhouse Village;
23. Izrael- Kompania izraelite bio-farmaceutike "Kamada Ltd" propozim për përdorimin në spitalet Shqiptare të mjekimit të zhvilluar prej tyre në luftën kundër Covid-19;
24. Izrael- Konferenca online midis drejtuesve të kompanisë izraelite "Lark Air" dhe autoriteteve të Aeroportit të Kukësit me qëllim konkretizimin e vizitës në Shqipëri, përzgjedhjen e zonës së investimeve, e cila është dakordësuar paraprakisht sa i takon çmimit dhe hapësirën e sipërfaqes, si dhe për marrjen e lejes për vendosjen e aktiviteteve të biznesit, etj. 12 maj 2021;
25. Izrael- Kompania Cellebrite e fokusuar në ofrimin e teknologjisë së inteligjencës dixhitale në drejtim të organizmave ligjzbatuese, policisë, institucioneve shtetërore përgjegjëse për kontrollin e kufirit, me qëllim reduktimin e kohës së investigimit etj, duke ofruar platforma për analizimin dhe nxjerrjen e të dhënave nga telefonat;
26. Kanada- Adresuar tek AIDA interesi për bashkëpunim i Korporatës së Investimeve në Alberta, Kanada;
27. Kinë- Propozimi i kompanisë "Saja Invest Trading" përfaqësuese e China National Biotec Group (Sinopharm CNBG) në Evropë, për realizimin e dërgimit të shpejtë të vaksinave në Shqipëri;
28. Kroaci- Përfaqësuesit e Kompanisë kroate ALTPRO interes për investim në fushën e infrastrukturës hekurudhore;
29. Kuvajt- Ndërmjetësohet video-konferencë mes kompanisë kuvajtiane "EnerTech" Holding Company" me përfaqësues të AIDA-s. Kompania e interesuar për investime në fushën e energjisë, energjisë së rinovueshme, ujit, riciklimit, menaxhimit të mbetjeve, etj 14 janar 2021;
30. Kuvajt- Negociohet me AIDA-n dhe Ministrinë e linjës realizmi i një video-konferencë me përfaqësues të kompanisë kuvajtiane "EnerTech Holding Company", të interesuar për bashkëpunim dhe investim në projekte konkrete shqiptare që ofron Shqipëria në fushën e energjisë, energjisë së rinovueshme, ujit, riciklimit, menaxhimit të mbetjeve, etj;
31. Lituani- Negociohet lidhja mes kompanive dhe bizneseve tona (rreth 100 syresh) me Konsullin e Nderit në Lituani, z. Dariu Pinkevicius për nxitjen e bashkëpunimit mes bizneseve prodhues dhe eksportues shqiptarë dhe supermarketeve lituaneze, Maxima, Rimi, Lidl, etj;
32. Maqedoni e veriut- Një kompani transporti skrap (hekur, plastik) nga Maqedonia e Veriut kërkon informacion se ku duhet të merret leja për transport skrap nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë;
33. Kompania FLIR System- Kërkon një pikë kontakti në Shërbimin Hidrografik Shqiptar mbi marrjen e një info për qasje në të dhënat e grafikut, hartografinë shqiptare, për lundrim në det.
34. Kompania 'OnSite waste Technologies'- Kërkon një takim përmes Zoom me zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë;
35. Poloni- Janë adresuar pranë AIDA-s kontakte të kompanive polake me interes për bashkëpunim me kompani apo/dhe institucione shqiptare; për partnerë dhe për të hyrë në tregun shqiptar nga sektori agro-ushqimor, IT, ICT, mjekësi dhe farmaceutikë, fushë ushtarake dhe investime;

36. Rumani- Asistohet me informacion kompania më e madhe rumune për industrinë kimike në Rumani Chimcomplex, e cila po studion edhe mundësinë e shtrirjes së aktivitetit edhe në Shqipëri, mbi industrinë petro-kimike në Shqipëri;
37. Slloveni- Adresuar pranë MIE dhe INSTAT kërkesa për informacion e kompanisë logjistike sllovene “Intereuropa” mbi transportin dhe transportin e mallrave në rrugë tokësore;
38. Slloveni- Asistohet dhe negociohet me AIDA-n interesi i Konsorciumit 4GS Global Solution, për një vizitë në Tiranë dhe takim me autoritetet përgjegjëse të fushës. Interes për financimin e projekteve të mundshme në ndërtim tuneli, autostrada, ura, etj.;
39. Serbi - Kompani serbe Projekti Promocija Ronjenja LTD e interesuar për mbrojtjen e nën detit në Shqipëri vizitë ë Tiranë në 17-21 qershor dhe takim me drejtues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, për të diskutuar konkretisht në detaje realizimin e këtij projekti.;
40. SHBA- Negocimi i një takimi online mes kompaninë amerikane “OnSite waste Technologies”, Uashington, e cila ofron një sistem të modernizuar për trajtimin e mbetjeve mjekësore me MSHMS;
41. Turqi- Kompania turke GUFO TRADE synon të futet në tregun shqiptar me produktet e saj dhe të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me kompani shqiptare;
42. Turqi- Kërkesë e kompanisë së turizmit shëndetësor “Güçlü Albayrak” për të dhënat e komunikimit të qendrave shëndetësore në Shqipëri;
43. Zvicër- Kompanisë Glencore, një nga kompanitë më të mëdha në botë të përpunimit të burimeve natyrore me një larmishmëri globale;
44. Sloveni- Kërkesë e kompanisë INTEREUROPA për info dhe të dhëna logjistike për Shqipëri;
45. Zvicër - Interes i shtetasit zviceran i interesuar për një sipërfaqe toke 10.000 m2 për ndërtimin e një fabrike për përpunimin e metaleve, në bashkëpunim me AIDA-n;
46. Kroaci- Interesi i kompanisë Techno-Trailers Ltd;
47. Kërkesë e kompanisë PROMOCIJA RONJENJA LTD, për realizimin e një takimi me Ministrin, z. Blendi Klosi;
48. Hungari- 16 nëntor 2021 dakortësohet dhe realizohet takimi i z. Robert Papp, Drejtor Administrativ i kompanisë SolarKraft dhe bashkëpunëtorët e tij me kolegët e AIDA-s lidhur me mundësitë e investimit në energjinë e rinovueshme në Shqipëri;
49. Austri- Kompani austriake interes për të qenë prezent në Shqipëri, kryesisht në fushën e menaxhimit të ujërave, si dhe zhvillimit të sektorit të hekurudhave, në projektim, ndërtim dhe menaxhim;
50. Angli- Kompania ligjore Goodman Derrick LLP, ka informuar se disa klientë të tyre janë shumë të interesuar për të investuar në Shqipëri në: projekte zhvillimi të pasurive të patundshme (real estate), zhvillimin e infrastrukturës; menaxhimin dhe përpunimin me kosto të ulët të mbetjeve urbane (një model bashkëngjitur); projekte që lidhen me bujqësinë (mbjelljen e një lloji drithi që përdoret për prodhimin e biofuel), përmbledhje e propozimit konkret bashkëngjitur; projekte për fushën e turizmit; projekte në fushën e energjisë, duke u përqëndruar te energjia diellore dhe hidrogjeni;
51. Bullgari- Kompania Jupiter Holding Bulgaria, një shoqëri aksionare me kapital 100% bullgar dhe përfshin Jupiter 05 LTD, Jupiter Metal LTD, fabrikën e galvanizimit dhe Spa Hotel Persenk. Kompania ka fabrikë për prodhimin e konstruksioneve metalike, objekte prodhimi për sistemet e fiksimit të automjeteve rrugore dhe tre impiante galvanizimi të nxehtë. Interes për bashkëpunime dhe partneritete në Shqipëri;
52. Bullgari- Kompania Valina AD, prodhuese e veshjeve për femra të klasit të lartë për tregun evropian kërkon partnerë nga Shqipëria për bashkëpunim;
53. Çeki- Një delegacion biznesi i disa kompanive çeke zhvillojnë një vizitë në Shqipëri nga data 1-5 maj 2022. Delegacioni përbëhet nga z. Michal Jirkovský, drejtor menaxhues i Xenia Co (kompani import i përgjithshëm); znj. Dana Hrdinová, përfaqësuese e kompanisë inxhinierike Metroprojekt (në fushën e ndërtimit); z. Daniel Rum, (drejtor komercial dhe bashkëpronar i producentit RGT); z. Dvur Kralove përfaqësues i Kompanisë së



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËJ BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

prodhimit të shufrave ftohës, tavolinave dhe kutive për mbajtje dhe ruajtja e artikujve ushqimorë. Të interesuar për investime ose bashkëpunime me biznese vendase dhe kërkojnë organizimin e takimeve me ministër apo zv. ministër në sektorin e ndërtimit. Takime me biznesmenë të fuqishëm në fushën e industrisë ushqimore pasi duam të importojmë salsiçe, djathë dhe çokollatë nga Shqipëria, si dhe biznesmenë të interesuar për blerjen e banakëve të ftohjes ushqimore për ruajtjen e produkteve ushqimore si qumësht, kos, djath etj.;

54. Danimarkë- Kërkesë e kompanisë daneze Moland Groip A/S, nëpërmjet Ambasadës tonë në Kopenhagen, për t'u lidhur me furnizues të kallëpeve të çimentos;

55. Greqi - Interesi i kompanisë Greke "Greek Water Airports" me seli në Athinë e cila po ndërton aktualisht 73 hidroporte në zona turistike të shtrira në Republikën Helene, për të shtrirë investimet e saj dhe në vendin tonë, lidhur me zonat turistike bregdetare;

56. Greqi- Kompania RCP Resource Project Management Lda, një kompani me sipërmarrje të përbashkët dhe me qendër në Portugali, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Greqi, z.Thomas Ferfiris, ka shprehur interesin për zbatimin e një projekti "high-tech green technology" në Shqipëri;

57. Izrael- 5 përfaqësues të Bordit të sipërmarrjes izraelite Big Mall Center (2 prej të cilëve me qendër në Beograd) zhvillojnë një vizitë zyrtare në Shqipëri. Qëllimi i vizitës dhe i takimeve me Kryebashkiakun e Tiranës, Kryetarët e Bashkive të Korçës, Elbasanit, Fierit dhe Vlorës është përfundimi i procedurave për investimet që kjo kompani do të bëjë në Tiranë dhe qytetet e mësipërme për ndërtimin e qendrave të reja tregtare e logjistike;

58. Izrael- Kompania OBG Soft, e cila ofron shërbime në fushën e mjekësisë, specifikisht lidhur me teknologjinë e fertilizimit në shëndetin riprodhues in Vitro/IVF;

59. Izrael- 'Letter of Intent' e kompanisë GoldLinks për krijimin e Data Center-it në kryeqytetin e Shqipërisë si pjesë organike e Mega Projektit të Bashkisë së Tiranës 'Techno-Park ku parashikohet që bashkëpunimi të jetë për 30 vite, me të drejtë vijimin e tij edhe për 20 vite të tjera. Ky bashkëpunim do të fokusohet në Cyber Services dhe Cyber Simulator;

60. Izrael- Kompania shtetërore izraelite, Elta System Ltd dakordëson me Bashkinë e Korçës për të nënshkruar një MoU për krijimin e një Regional Cyber Center me Head Quarter në Korçë. Kompania izraelite merr përsipër financimin për ndërtimin e kësaj qendre rajonale kibernetike dhe Bashkia e Korçës ofron të gjithë fasilitetet për ndërtimin e saj dhe lejen përkatëse;

61. Izrael- Kompania wissmann Holding interes për të bashkëpunuar me kompani shqiptare të fushës së mobilierisë, për eksporte në Izrael;

62. Izrael- Kompania G.N.G Green, e cila zhvillon aktivitetin e saj në industrinë ushqimore për kafshët, interes për partnerë shqiptare që operojnë në këtë fushë, për të importuar nënprodukte nga vaji sojë/ soybean oil plants, të prodhuar në Shqipëri;

63. Izrael- Kompania Vittorio Divani L.t.d që operon prej 18 vitesh në fushën e prodhimit të mobiljeve ka shprehur interes për të bashkëpunuar me tregun shqiptar;

64. Izrael- Kompania OurCrowd interes për të hyrë në tregun shqiptar. Kompania është e specializuar në krijimin e një network-u global inkubatorësh, me mbështetjen e qeverive, (4 inkubatorë në Izrael dhe 1 në Zelandën e Re), si dhe është në kërkim të krijimit të inkubatorëve të tjerë në mbarë botën;

65. Izrael- Kompania APCO Aviation Ltd, duan të implementojnë një projekt që parashikon hapjen e një fabrike për të prodhuar paisjet e instrumentat bazë për parashutat, hedhjet me parashutat me motor, deri tek dronët sportive. Investimi në Shqipëri do të jetë 5-7 milionë dollarë, blerjen ose marrjen me qera të truallit ku do ndërtohet fabrika, në rreth 2.000 metra katrorë dhe punësime të 300 vetëve, kryesisht të rinj. Lëndët e para e makineritë do t'i sjellë sipërmarrja dhe prodhimet do eksportohen në tregun e Europës Lindore e Azisë;

66. Indi- Kompania indiane Asia Pacific Ceramic <https://asiapacificceramic.com/export/> interes për të hapur një magazinë në Shqipëri me një partner vendas gjithashtu i interesuar për të njëjtën gjë, e cila do të shërbejë dhe si një pikë shpërndarje për Shqipërinë dhe tregjet përreth.

67. Indi- Kompania indiane Jenny Export Kart <https://www.jennyexpokart.com/> eksportues kryesor i orizit, grurit, erëzave indiane, çajit, kafesë, drithërave, pulseve, arrave, frutave të stinës si mango dhe litchis, dhe punimeve artizanale dhe mëndafshi, kërkon partner tregtar.
68. Katar- Asistohet Menaxheri i Përgjithshëm (MP) i kompanisë Najmah Firdous, Katar, i cili viziton Tiranën për grumbullimin e një informacion mbi produktet shqiptare që mund të eksportohen në Katar, si vaj lule dielli me cilësi europiane dhe me cmim konkurues, pula të ngrira, vezë, të gjitha llojet e yndyrnave ushqimore, ujë, deri edhe fruta, kryesisht portokalle, mandarina dhe limona;
69. Katar - Interesi i kompanisë katarze Obra Solutions, kompani me eksperiencën e duhur si dhe të gjitha burimet njerëzore dhe financiare, për të bërë informatizimin e porteve, që të marrin pjesë në një tender ndër-kombëtar për informatizimin e portit të Durrësit;
70. Kuvajt- Group General manager of Qgo Groupinteresi për të parë nga afër mundësitë që ofron Shqipëria në fushën e turizmit;
71. Mal i Zi- Kompania malazeze “Barska plovdba” kërkon një partner në Shqipëri që do të merrte përsipër linjën me traget Bar (Tivar) – Bari (Itali);
72. Rumani- Kompania LAPP Romania, një kompani e njohur në të gjithë botën në industrinë e telave dhe kabllove të madhësive të ndryshme interes për të zhvilluar një projekt bashkëpunimi me Shqipërinë, i cili më vonë mund të zgjerohet edhe në Kosovë e në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
73. Lituani- Në bashkëpunim me Konsullin tonë të Nderit në Lituani promovimi i 13 kompanive shqiptare dhe produkteve të tyre me fokus futjen e tyre në supermarketet lituaneze;
74. Asistohet kompania INCA- Industry of Natural Casings in Albania, për zgjerim tregu dhe të investimeve në sektorin e përpunimit të nënprodukteve për industrinë e përpunimit të mishit dhe në Kosovë.
75. Itali- Kompania italiane Co.Me.CA. S.r.l (e certifikuar ISO 9001) që merret me sistemet e reduktimit, matjes dhe kompensimit të gazit të lëngshëm dhe që projekton dhe instalon sisteme të të gjitha llojeve për nevoja private/publike, duke ofruar mirëmbajtjen përkatëse dhe të gjitha shërbimet ndihmëse e interesuar për të vlerësuar investime në Shqipëri për projekte, publike dhe private, në sektorin LNG në kërkim të identifikimit të interlokutorëve të kualifikuar në vendin tonë (publik ose privat), për t’i paraqitur projektin dhe prej të cilëve mund të merret mbështetja e duhur për zbatimin e tij. Takime në Shqipëri me interlokutorët në fjalë për të konkretizuar projektin.
76. Austri- Firma austriake Kennametal, www.kennametal.com | www.widia.com një nga lojtarët kryesorë në tregun global të prerjes së metaleve, me seli në SHBA dhe filiale në disa vende. Gama e tyre përfshin të gjitha mjetet për prerjen e metaleve në makinat konvencionale. E interesuar të hapet në tregun shqiptar me një partner tregtar kompetent. I përcillet lista e kompanive shqiptare që oprojnë në këtë sektorë
77. Gjermani- Kompania 2Real dhe Kompania Hoffman&Collegen Interes të hapin një fabrikë prodhimi në Shqipëri për panelet diellore.
78. Greqi- ART LIFT AEBE, kompani prodhimi ashensorë dhe teleferiku me bazë në Greqi. E interesuar të realizojë në Shqipëri një projekt, të instalojë ashensor në Shqipëri, por nuk ka seli fizike në Shqipëri dhe nuk e di nëse i lejohet kjo pa patur një seli këtu. Po ashtu kërkon të dijë se si duhet të sigurohen punëtorët në Shqipëri gjatë punimeve. Asistohet me informacion mbi legjislacionin shtetëror për aktivitetin e tyre;
79. Bullgari- Kompania Infinity Ltd. që operon në sektorin e IT-së të interesuar për vendosjen e kontakteve me organizatat tregtare të industrisë, si dhe me kompanitë/organizatat e interesuara me subjektet e interesuara shqiptare për zgjidhjet dhe shërbimet që kompania e tyre ofron.
80. Greqi- Kompania Zündapp Motors and Finance, e cila ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një kompani shqiptare për tregtimin e motocikletave e interesuar të njihet me dokumentacionin e nevojshëm doganor për futjen e këtyre produkteve në territorin shqiptar.
- në Shqipëri.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËJ BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

81. Greqi- Kërkesë e kompanisë A-Raptis packing, e cila merret me tregtimin e çantave prej letre, të cilat printon dhe u vendos mbajtëset për partneritet tregtar me fabrika dhe shtypshkronja të cilat prodhojnë dhe eksportojnë çanta prej letre në Greqi dhe Itali, kërkojnë kontakte me ta;
82. Greqi- Kompania greke EVAL – E.G. Vallianatos S.A. një kompani lider në fushën e prodhimit të pajisjeve dhe aksesorëve detarë për shpëtimin e jetës, anijet e pasagjerëve dhe varkat e interesuar për partner tregtar në Shqipëri.
83. Greqi- Kompania greke Soutas Import Agencies, e cila aktivizohet në fushën e importit dhe shitjeve të baterive të makinave dhe pjesëve të këmbimit të makinave në Greqi, kërkon informacion mbi kompanitë shqiptare me aktivitet në Shqipëri dhe me objekt importin e dhe tregtimin e baterive të makinave dhe pjesëve të këmbimit;
84. Greqi- Kompania greke “Fratelli” e cila aktivizohet në fushën e tregtisë, interesohet për bashkëpunim me kompani qepjesh në Shqipëri për disa produkte të caktuara si çanta pambuku, t-shirt, kapele etj.;
85. Kore- Kompania koreane KOTRA Athens, e interesuar për informacion mbi mjetet mjekësore diagnostikuese in vitro dhe procedurat e regjistrimit për disa produkte;
86. Austri- Kërkese e firmës NIRO në rajonin e Grazit, për tu vendosur në komunikim me pronar fidanishteje për drurët frutore në Shqipëri, për të blerë 100 -200 rrënjë dru gështenje rreth 1,5 metra të larta (Edelkastanien) si dhe të vendosë kontakte për projekte të tjera mbi zhvillimin e qëndrueshëm të gështenjës;
87. Slloveni- Kompania sllovene, GEOR PLUS d.o.o , e specializuar në prodhimin e enëve të kuzhinës, veglave dhe enëve (dy mijë produkte të ndryshme) të bëra nga plastika, inoksi dhe druri e interesuar për partner tregtar nga Shqipëria;
88. Kompania daneze “Navitaswind S/A asistohet me informacion lidhur me procedurat ligjore dhe kriteret që duhet të përmbushë ajo për të aplikuar dhe hyrë si nën kontraktore në partneritet me një kompani shqiptare, përfshirë personelin e saj, për një projekt privat në vendin tonë. Projekti ka të bëjë me instalimin dhe dekomisionimin e turbinave të ajrit përfshirë mbështetjen dhe konsulencën teknike gjatë procesit të montimit, programeve kompjuterike dhe zbatimit teknik në terren.
89. Kompania italiane Sparkle” është pjese e Operatorit Global te Grupit TIM (Telecom Italia Mobile), ofruesi i parë ndërkombëtar i shërbimeve në Itali dhe ndër më të mëdhenjtë në Itali dhe është aktiv në mbarë botën, dhe si shpërndarës momentalisht vepron në 32 vende, Propozon bashkëpunim me Shqipërinë, MIE_n, për sa i përket infrastrukturës së furnizimit me fibër optike përmes kabllorit detar nënujor. Kompania Sparkle, ka iniciuar edhe një projekt zhvillimi të quajtur “GreenMed”, i cili do të jetë një sistem i ri kabllor detar nënujor që do të kaloj detin Adriatik duke lidhur Italinë me Kroacinë, Malin e Zi, Shqipërinë, Greqinë dhe Turqinë, përpara se të shtrihet më tej në Mesdhe. Adresohet tek MIE.
90. Kompania greke Armiriki, e interesuar për importin nga Shqipëria të produktit livando e tharë e përpunuar pa kërcell. Asistohet me të dhëna për prodhues, grumbullues dhe eksportues shqiptarë të këtij produkti;
91. Kompania shtetërore kineze “Shandong Hi-Speed Group Co. Ltd.” e interesuar mbi mundësitë e investimeve në vendin tonë, kryesisht në fushën e infrastrukturës rrugore, hekurudhore, ndërtimeve civile, etj;
92. Grupimi i Bizneseve të Mermerit GOURLI EPE, me seli në Atikë, Asistohet me listën e partnerëve shqiptar të mermerit në Shqipëri. Kompania zvicerane “Sun-Ëays” me seli në Lozanë të Zvicrës, të drejtuar nga Joseph Scuderi i gatshëm për zhvillimin e një projekti inovativ në Shqipëri. synon të ndryshojë mënyrën e prodhimit të energjisë diellore, duke instaluar panele diellore të lëvizshme midis binarëve hekurudhorë. CEO i kësaj kompanie, Joseph Scuderi, realizon vizitë në 17 prill 2024 në Shqipëri, për testimin e këtij projekti kaq inovativ për herë të parë në vendin tonë;
93. Greqi- Grupi “Elizabeth LaGre”, një stiliste e brezit të tretë, ofron perspektivën e saj në industrinë e veshjeve. Interes për bashkëpunim me kompani shqiptare që operojnë në Shqipëri.

94. Greqi- “SALAS International Group”, e specializuar në përgatitjen dhe shpërndarjen e paketave të ndihmës humanitare për OJQ, organizata ndërkombëtare, pushtetin lokal dhe entitetet qeveritare. Respektimin e standardeve ndërkombëtare. Interes për të lidhur bashkëpunim me kompani shqiptare/entitete qeveritare si kompani konsulence lidhur me ndihmat humanitare për të gjitha çështjet dhe situatat që lidhen me refugjatët dhe migrantët;
95. Greqi- Kompania “Uniformat Lago”, e specializuar në uniformat profesionale të cilësisë së lartë me specifi- ka estetike e interesuar për bashkëpunim me kompani shqiptare që operojnë në Shqipëri;
96. Greqi- Kompania ambalazhit Fokas Packaging ka patentën për krijimin e një shishe inovative të për- shtatshme për vaj, verë dhe pije alkoolike. E interesuar të vendoset në komunikim me prodhues vere, vaj ulliri dhe distilues në Shqipëri.
97. Greqi- Kompania “Simply Smoothies Hellas”, interes për bashkëpunim tregtar me kompani tregtare shqip- tare që operojnë në Shqipëri, në fushën e shpërndarjes së produkteve të ngrira (smoothies), produkteve të thata (shishe smoothie – fruit puree- shurupe etj.);
98. Greqi- Kompania “KMMB GP” ka shprehur interesin për bashkëpunim me kompani shqiptare që operojnë në Shqipëri, në sektorin e industrisë, energjisë, ushqimeve;
99. Greqi- Kompania “KMMB GP” interes për bashkëpunim me kompani shqiptare që operojnë në Shqipëri, në sektorin e industrisë, energjisë, ushqimeve;
100. Norvegji- Kompania “Gausdal Sewing Industry”, www.gsi.no e qepjes industriale, më 15 punonjës, e cila funksionon që nga viti 1985 e interesuar të gjejë një partner prodhimi shqiptar, i cili mund ta ndihmojë në prodhimin e produkteve industriale të qepjes si çanta, rripa, mbulesa mbrojtjeje, veshje mobiljesh, etj për kuj- desin shëndetësor, sportin, mbrojtjen dhe industrinë e tjera;
101. Sipërmarrja serbe “The Goden Spartan” operon në fushën e dermo-kozmetikës. Kërkon partner tregtar nga Shqipëria;
102. Kompani spanjolle TACNET ofron zgjidhje në ekosistemet që përdoret në ushtri dhe forcat speciale, si dhe në polici dhe grupe të tjera taktike. Kërkon partner nga Shqipëria;
103. Greqi- Kompania greke “Katradis” prodhon litarë detarë, si dhe fabrikon litarë me tela çeliku, zinxhirë dhe ankora, pajisje në kuvertën e anijeve, parafango gome dhe shkumë, pajisje për zhvillimin e portit etj e in- teresuar për partner tregtar në Shqipëri;
104. Kore- Satrec Initiative Imagign Services SIIS (<https://www.si-imaging.com/>) degë e kompanisë “Satrec Initiative Co.LTD”, prodhon dhe eksporton satelitë të madhësive të mesme dhe të mëdha. kërkon një pikë kon- takti të një personi kompetent, kompanie apo organizate në Shqipëri, e cila aktivizohet në lëmin e imazheve satelitore, përfshirë operacionet satelitore;
105. Poloni- Respect Energy, Respect Energy Website Ka dorëzuar dokumentet e nevojshme pranë AIDA-s për të marrë statusin e investitorit strategjik për projektet e tyre të energjisë së rinovueshme, veçanërisht në energjinë e erës dhe diellit. Në të ardhmen synojnë gjithashtu të zbatojnë projekte që përfshijnë prodhimin e hidrogjenit të gjelbër dhe amoniakut.
106. Kompania daneze JMV Cables kërkojnë një listë me prodhuesit/furnizuesit, të cilët janë në gjendje të prodhojnë ose shpërndajnë kablllo të tensionit të mesëm dhe të lartë, si dhe kablllo të energjisë dhe furnizimit me përçues bakri dhe alumini;
107. VVT Engineering Ltd., një nga kompanitë e njohura bullgare në fushën e energjisë së rinovueshme, e specializuar në konsulencë, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e centraleve fotovoltaike, me një ekip të përkushtuar specialistësh, që ofrojnë projekte individuale të përshtatura sipas kërkesave dhe aspiratave unike të klientëve të tyre. Interes për të operuar në tregun shqiptar dhe mundësi bashkëpunimi me kompani shqip- tare që operojnë në fushën e energjisë së rinovueshme si dhe vendosje kontaktesh me sipërmarrës shqiptarë, Unionin e Dhomave të Tregtisë etj, me qëllim krijimin e partneriteteve strategjike apo bizneseve të përbashkëta



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

nga vendi ynë;

108. Kompania holandeze ECOPLANT, po zbaton një projekt në qytetin e Beratit me financimin e SHELL. Realizon një linjë prodhimi të produkteve të ECOPLANT;

109. Kompania greke "CRIPTIA SA", me seli në Selanik, e specializuar në zhvillimin e sistemeve inovative elektronike të zbulimit të insekteve, sisteme për kontrollin efektiv të dëmtuesve dhe mbrojtjen e shëndetit publik, e interesuar për partneritet me kompani shqiptare që operojnë në këtë sektorë, në kuadër të zgjerimit të aktiviteteve të tyre në tregun shqiptar;

110. Kompania "OnDeck Media" e cila promovon turizmin detar duke i ofruar tregut grek të jahteve dhe turizmit detar mjete promovimi dhe komunikimi ndërkombëtare dhe të estetikës së lartë në Greqi dhe jashtë saj. E interesuar për bashkëpunim me kompani shqiptare që operojnë në Shqipëri. Shoqata Greko-Shqiptare e Tregtisë, Industrisë dhe e Profesionistëve dhe kompania Rumming Idea, në bashkëpunim me Asosacionin e Industrive Atikë-Pire realizojnë një mision biznesi në Shqipëri me sipërmarrës nga Greqia. Qëllimi i misionit është promovimi i kompanive greko-shqiptare dhe forcimi i bashkëpunimit mes tyre;

111. Kompania greke "3alpha AFOI K. KARAGEORGIOU", e cila prodhon oriz dhe bishtajore e interesuar për partner tregtar në Shqipëri;

112. Kompania greke AGRODRIP S.A. <https://agrodrip.gr> prodhon dhe shet produkte vaditëse në Greqi dhe jashtë saj. Kërkojnë një listë me kompanitë shqiptare të cilat janë të orientuara në tregtinë me shumicë që importojnë/eksportojnë produkte si të tyre;

113. Izrael- Kompania Electra Elevator përfaqëson ashensorët OTIS. Të interesuar për të bashkëpunuar me kompani/fabrika të prodhimit të metaleve në Shqipëri, prodhimi i kompleteve për instalimin e ashensorëve;

114. Kompania bullgare Tempus Link Ltd kërkon të vendosë marrëdhënie tregtare të një grupi kompanish nga Republika e Bullgarisë dhe Mbretëria e Spanjës me Republikën e Shqipërisë, në fushën e industrisë së mbrojtjes. E interesuar në vendosjen e kontakteve me fabrikat në Elbasan, Poliçan dhe Gramsh, si dhe mundësimin e organizimit të një vizite të një përfaqësie të tyre në këto fabrika;

115. Grupi gjerman RTK -Raiffeisen Touristik Group RTK i drejtuar nga z. Bösl i interesuar të nisë një bashkëpunim me Shqipërinë për të vendosur shërbimin charter dhe furnizimin me turistë gjatë gjithë vitit;

116. DENA- Agjensia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Energjinë kërkon angazhim me strukturat shqiptare për bashkëpunim në fushën e energjisë së rinovueshme (floating PV, green electricity and hydrogen exports);

117. Menti Verdi, www.mentiverdi.com e interesur të zgjerojë gamën e tyre të furnizuesve ndërkombëtarë dhe interesohen të lidhen me kompanitë që kërkojnë të eksportojnë në Norvegji.

Mbështetje dhe promovim i kompanive shqiptare për partner biznesi, tregtar dhe produkte.

Përfaqësitë e Shqipërisë jashtë vendit përcjellin profilet e kompanive vendase tek dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit ose grupet e interesit, asistojnë kompanitë me informacion dhe të dhëna për kuadrin ligjor dhe institucional, informacion për tregjet, informacion për aktivitetet, panairët apo ekspozitat ndërkombëtare.

1. Promovimin e kompanise shqiptare "Kop Frut", Dibër, jashtë Shqipërisë, në tregjet evropiane, amerikane dhe jo vetëm;

2. Realizimin i një studimi mbi sipërfaqen e tokës së vreshtave që përdoren në Shqipëri për prodhimin e verës "Kallmet";

3. Promovim i kompanisë shqiptare "SofrAlb";

4. Ndërmjetësim për lehtësimin e procedurave me qëllim eksportin e mollëve të Korçës, drejt Egjiptit;

5. Suport për import- export për kompaninë shqiptare "ARPI" shpk;

6. Kërkesa nga Franca për informacion mbi firmat e huaja të kozmetikës, brandet e huaja dhe xhiro vjetore e këtyre prodhimeve, buxheti vjetor që kanë për marketingun;

7. Shkëmbehet informacion mbi masat parandaluese dhe certifikatat për eksportimin e disa produkteve në EBA;
8. Shkëmbehet informacion lidhur me përcaktimin e kushteve shëndetësore që duhen plotësuar, në mënyrë që të mundësohet eksporti i produktit ushqimor “Vezë e Lëngshme e Pasterizuar” drejt Bosnje Hercegovinës;
9. Promovimi i Institutit shqiptar të NMVM-ve “NMVM Albania”.
10. Kompania FMT Servomatik Shpk, degë e brandit FMT Group, u asistua me informacion mbi gjetjen e mundësisë së protokolleve të bashkëpunimit, me kontrata specifike, për të realizuar tregtinë e produkteve të tyre me Tunizinë.
11. Kompania “Fix”, e interesuar për të filluar një marrëveshje pune me kompaninë namibiane “Macadel Trading Enterprise” u asistua me informacion mbi kompaninë namibiane “Macadel”.

Aktiviteti 1.1.1.2: Rishikimi i fokusit të grupit të synuar dhe përgatitja e një strategjie koherente të promovimit të investimeve

AIDA ka planifikuar zhvillimin e një fushate outreach në sektorin ICT/BPO në vitin 2025, si edhe një fushatë outreach, në sektorin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik, në bashkëpunim me TEDA Tirana shpk.

1.1.1.3 Mirëmbajtja e CRM:

CRM (menaxhimi i marrëdhënieve me klientët) është një platformë që mundëson menaxhimin dhe analizën e ndërveprimeve dhe të të dhënave të klientëve. Qëllimi i përdorimit të kësaj platforme është të përmirësojë marrëdhëniet e shërbimeve që ofrohen nga dhe nëpërmjet AIDA.

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Promovimi/lehtësimi sistematik i investimeve të synuara	- 7 fushata specifike të targetimit për grupet e synuara - 51 projekte tërheqëse të investimeve - 127,500 mijë euro volumi i investimeve - krijimi i 15,300 vende pune të reja	3 fushata, 1 fushatë në proces

1.1.2 Masa “Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme”.

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, bashkitë, dhomat dhe shoqatat e biznesit.

Progresi në zbatimin:

Nga ana e AIDA janë kryer aktivitete për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme.

Përmbledhje

1.1.2.1 Intensifikimi i masave të “after-care” bazuar në një qasje të strukturuar.

Aftercare

- **Gjatë vitit 2021**, Sektori AfterCare iu rikthye aktivitetit normal pas periudhës njëvjeçare të pandemisë, e cila kushtëzoi veprimtarinë e sektorit pa takime pranë bizneseve, por përmes ndërlidhjes nëpërmjet pyetësorëve apo asistencës në distancë. Plani i veprimit i parashikuar për vitin 2020 u zhvendos në 2021, me zgjerimin me dy bashki të reja: Kavajë dhe Vorë. Në vitin 2021 janë zhvilluar 12 takime pranë bizneseve dhe 2 takime në shkollat profesionale. Gjithashtu janë finalizuar me sukses 12 aktivitete asistencë, ndërsa 8 çështje kanë qenë në ndjekje.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËJ BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

- **Gjatë vitit 2022**, janë zhvilluar në total 21 takime pranë kompanive me kapital të huaj, të përbashkët dhe vendas. Përpos kësaj, janë zhvilluar takime dhe pranë 2 shkollave profesionale. Gjithashtu janë finalizuar me sukses 7 aktivitete asistence.
 - **Gjatë vitit 2023** janë zhvilluar 35 takime me subjekte që operojnë në sektorë të ndryshëm, përkatësisht 13 takime me subjekte në turizëm, 8 në manifakturë, 3 në ndërtim, 2 në energji dhe pjesa tjetër e takimeve janë zhvilluar në sektorë si transporti, miniera, agropërpunimi etj.
 - **Përgjatë vitit 2024** AIDA ka takuar 163 kompani përmes vizitave në terren, tryezave të rrumbullakëta por dhe përmes takimeve të investitorëve të huaj në vendin tonë, duke përmbyshur kështu një detyrë të dyfishtë si dhe ka asistuar 18 subjekte për problematika të natyrave të ndryshme.
- Në total janë zhvilluar 235 takime për periudhën 2021-2024.
- **Gjatë vitit 2024**, Sektori Lead & Aftercare pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA organizoi 2 fushata të shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorit, 2 tryeza të rrumbullakëta me kompani të sektorit automotiv dhe turizmit si dhe ndërmori nismën “Investor Support Days”. Rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale funksionon aktualisht me 12 bashki të vendit, përkatësisht Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan, Kavajë, Vorë, Kamëz dhe në 2024 me bashkinë Korçë.

Aktiviteti 1.1.2.2: Zgjerimi i portofolit të shërbimeve duke gjeneruar sinergji me veprime të tjera prioritare (p.sh. zhvillimi i aftësive, promovimi i lidhjeve, zhvillimi i furnitorëve)

Memorandume të nënshkruara

Përgjatë periudhës 2021 – 2024, AIDA ka nënshkruar 16 memorandume bashkëpunimi me bashki, agjenci homologe dhe partnerë të tjerë, si më poshtë vijon:

- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë – 2021
- Bashkia Kavajë– 2021
- Bashkia Vorë– 2021
- Enterprise Greece (Investment and Promotion Agency)– 2022
- Swiss Promotion Programe (SIPPO)- 2022
- Dhoma e Tregtisë Zviceriane- Shqiptare (SWISSA)- 2022
- PAIH (Polish Investment and Trade Agency)– 2023
- Dhoma Ekonomike Italiane (CCIRC)– 2023
- Shoqata E Tregtisë Elektronike (E-commerce)- 2023
- Shoqata Jofitimpruresë Unioni i Prodhuesve të Verës- 2023
- Bashkia Kamëz– 2023
- Bashkia Korçë– 2024
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi (ATTSO)- 2024
- Montenegrin Investment Agency (MIA)– 2024
- Hungarian Export Promotion Agency (HEPA)– 2024
- Instituti I Politikave të Qëndrueshme (ISP)- 2024

Gjenerimi i LEADS

AIDA vazhdimisht asiston kompanitë e interesuara duke u mundësuar informacion të përditësuar mbi klimën e biznesit në Shqipëri, sistemin e taksave, lehtësirat që ofrohen për investitorët e huaj, kuadrin ligjor për investimet, mundësitë për partneritete me biznese vendase, etj.

- **Në fund të vitit 2021** rezultojnë që nga të gjitha projektet “Lead”, 15 prej tyre vazhdojnë ende të ngelen aktive.

- **Përgjatë vitit 2022** u arrit në total numri total prej 38 projekteve “Lead” në ndjekje nga AIDA (aktive dhe pasive), prej të cilave 4 janë projekte të materializuara. Duke mbajtur parasysh që jo të gjitha investimet potenciale kanë shprehur vlerën e investimit dhe punësimin që do të gjenerojnë, konstatohet se vlera totale e këtyre investimeve arrin përafërsisht vlerën prej 223.3 milionë euro, ndërsa parashikohet që numri i të punësuarve në këto aktivitete të jetë mbi 5410.
- **Gjatë vitit 2023**, AIDA ndoqi 4 “Leads” të rinj, të cilët së bashku arrijnë një vlerë investimi prej 128 milionë euro.
- **Gjatë vitit 2024**, AIDA ndoqi 6 Leads të rinj si Lidl, Zuegg, Perutnina Ptuj, Tratos, Insit Group, Roncadin si edhe është riaktivizuar Lead i kompanisë Visccher-Caravelle. AIDA u ka ofruar këtyre kompanive akses në informacione të përfitueshme, ka përmirësuar komunikimin me organet qeveritare dhe po identifikon në mënyrë aktive opsionet e përshtatshme të tokës për disa prej tyre.

Forume biznesi

- **Në vitin 2023**, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri - Gjermani. Pjesëmarrësit kryesorë të këtij aktiviteti ishin rreth 40 biznese të reja gjermane të rrjetit “The Young Entrepreneurs” dhe rreth 60 biznese shqiptare me interesa direkte në fushat e bizneseve mike. Vizita e delegacionit gjerman kishte si qëllim njohjen më nga afër me potencialin dhe mundësitë konkrete që ka Shqipëria për investime, njohjen dhe prezantimin me projekte që mbështet Qeveria Shqiptare, por edhe me fusha të reja për investime të mundshme.
- **Në vitin 2023**, AIDA në bashkëpunim me Agjencinë Polake të Investimeve dhe Tregtisë (PAIH), organizoi Tryezën e Rrumbullakët të Biznesit “Poloni – Shqipëri”. AIDA dhe PAIH nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi, si hap i parë i një procesi të vazhdueshëm me qëllim forcimin e marrëdhënieve të ndërsjellta, por edhe ndarjen e eksperiencave institucionale, për të krijuar rrjetin mbështetës të nevojshëm për kompanitë e dy vendeve. Në përfundim u zhvilluan takimet B2B ndërmjet kompanive polake dhe atyre shqiptare.
- **Përgjatë 2024**, AIDA organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri – Arabi Saudite, i cili mbledhi së bashku rreth 50 biznese arabe dhe 50 biznese shqiptare. Forumi u përmyll me takimet B2B ndërmjet bizneseve të Arabisë Saudite dhe atyre shqiptare, si edhe me takimet B2G me përfaqësues të qeverisë shqiptare.
- **Përgjatë 2024**, AIDA në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Çeke në Shqipëri dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, organizuan Forumin e Biznesit Shqipëri – Çeki, si një dëshmi e vullnetit të përbashkët për të thelluar bashkëpunimin ekonomik dhe eksplorimin e mundësive dypalëshe për të nxitur partneritete, si dhe investime të reja. Në përfundim të forumit, u zhvillua dhe sesioni i takimeve B2B, ndërmjet kompanive shqiptare dhe atyre çeke, për të diskutuar mundësi konkrete bashkëpunimi dhe krijimin e partneriteteve në të ardhmen.
- **Në muajin Nëntor**, AIDA organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri – Emiratet e Bashkuara Arabe. Delegacioni i Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), i kryesuar nga Ministri për Tregtinë e Jashtme, Sh.T.Z. Thani Bin Ahmed Al Zeyoudi, përfshiu përfaqësues të kompanive elitare dhe solli mesazhe të qarta për rritjen e investimeve dhe shkëmbimeve tregtare. Eventu përfshiu diskutime strategjike dhe bisedime B2B mes kompanive të fushave si energjia, teknologjia dhe ndërtimi, duke vendosur bazat për projekte të reja. Ndër pjesëmarrësit e delegacionit nga pala e Emirateve të Bashkuara Arabe ishin kompani si Masdar, JAFZA, ADNOC Global Trading, Kumo Industries dhe Oumolat.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Program i strukturuar për shërbimin e përkujdesjes së mëtejshme	- 300 klientë të <i>after-care</i> (investitorët ekzistues) - 20 memorandume mirëkuptimi të nënshkruara me bashki/partnerë - 160 projekte të riinvestimit - 320,000 mijë EUR vëllimi i riinvestimit - 16,000 vende pune të krijuara nga investitorët ekzistues	Në total zhvilluar 72 takime AIDA ka nënshkruar 10 memorandume bashkëpunimi me bashki

1.1.3 Masa “Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve”

Institucioni udhëheqës: Ministri përgjegjës për ekonominë

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, Korporata Shqiptare e Investimeve.

Progresi në zbatimin:

MEKI ka kryer aktivitete lidhur me vlerësimin e programit të TEDA-ve.

Përmbledhje

1.1.3.1 Vlerësimi i programit TEDA dhe zhvillimi i një udhërrëfyese reformash

Me mbështetjen e ekspertëve të German Economic Team, Berlin është hartuar dhe prezantuar studimi “Opsionet e reformës për Zonat e Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik (TEDA) në Shqipëri”. Më 19 mars në MEKI u prezantua studim “Opsionet e reformës për Zonave të Zhvillimit Teknologjik dhe Ekonomik (TEDA) në Shqipëri”.

Lidhur me reformën e TEDA-s në drejtimin e Zëvendësministrit të MEKI-t puna për përgatitjen e studimit. Në mars 2024, ekspertët e GET team prezantuan në MEKI studimin mbi TEDA-t, përfshirë konkluzionet dhe rekomandime mbi opsionet e zhvillimit të tyre në Shqipëri, disa prej të cilave janë:

- Hartimi i një dokumenti/vizioni strategjik dhe një kuadër ligjor që i përgjigjet nevojave aktuale për zhvillimin e TEDA-ve;
- Në periudhë afatshkurtër, fokusimi në TEDA që alokojnë disa aktivitete dhe në zona të specializuara për të tërhequr projekte investimi që synojnë eksport, për të zhvilluar industri të caktuara;
- Në periudhë afat-mesëm, fokusimi në shkencë/teknologji dhe parqet industriale të gjelbra, për të nxitur inovacionin tranzicionin e gjelbër;
- Në periudhë afat-gjatë, kalimi nga incentivat ekzistuese që ofron ligji për TEDA në një kuadër ligjor që përmban programe incentivash për zhvillimin e investimeve

1.1.3.2 Përgatitja e një koncepti zhvillimi për një TEDA të përzgjedhur

Nuk raportohet për një aktivitet të zhvilluar.

RAPORT MONITORIMI 2021-2024



1.1.3.3 Zbatimi i konceptit të zhvillimit (infrastruktura jashtë / në vend për një TEDA të zgjedhur)

Nuk raportohet për një aktivitet të zhvilluar.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Vlerësimi dhe reforma e programit të TEDA-ve	- finalizimi i vlerësimit, udhëzuesit të reformës dhe konceptit të zhvillimit (deri në vitin 2022) - 30 ha tokë e zhvilluar/20 ha e përdorur nga investitorët në zonën e zgjedhur - 20 rezident aktivë në zonën e zgjedhur - 3,000 vende pune të reja të krijuara në zonën e zgjedhur	1 Raport vlerësimi për programin e TEDA

1.1.4 Masa “Programi i zhvillimit të ofruesve”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues: AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë

Aktiviteti 1.1.4.1: Hartimi i një programi të zhvillimit të ofruesve/furnizuesve dhe zbatimi i një programi pilot.

Nuk raportohet për një aktivitet të zhvilluar.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Programi i zhvillimit të ofruesve	- pjesëmarrje e 30 investitorëve deri më 2027 - pjesëmarrje e 150 bizneseve lokale deri më 2027 - lehtësimi i nënkontratave me vlerë 75 milionë euro deri më 2027	Na

1.1.5 Masa “Programi i eksporteve”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë.

Progresi në zbatimin:



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

- **Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritje.**

- Miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve (Dhjetor 2025).
- Progres i arritur në iniciativat rregullatore (Dhjetor 2025 / Qershor 2026) dhe/ose masat mbështetëse në lidhje me partneritetet e zinxhirit të vlerës industriale me Bashkimin Evropian (Dhjetor 2027).
- Rritja e peshës së eksporteve (shërbime dhe mallra) ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB, ku pesha e eksporteve ndaj PBB-së është në vlerë neto 40% (Qershor 2027).

Përmbledhje

Aktiviteti 1.1.5.1 : Hartimi i programit të eksporteve

Strategjia e Eksporteve

Në vitin 2022, AIDA, si pjesë e grupit të punës, ka përgatitur pyetësorin e eksporteve dhe me miratimin e grupit të punës, ka anketuar 325 kompani për të vlerësuar situatën aktuale mbi eksportet e tyre dhe për të marrë parasysh nevojat e tyre në strategjinë e eksportit. Të dhënat janë mbledhur në mënyrë konfidenciale dhe mbulojnë periudhën nga 23 mars deri më 31 maj 2022. Pyetësorit iu përgjigjën 130 kompani. Pas analizimit të rezultateve të pyetësorit, u identifikuan masat dhe shërbimet në dispozicion të Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në mbështetje të aktiviteteve të tyre eksportuese, qasjet/propozimet më të mira dhe të suksesshme dhe masat proaktive për të stimuluar eksportet dhe për të ofruar mbështetje (financiare dhe jofinanciare) për bizneset.

Fushata “Made in Albania”

“Made in Albania” është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve “Made in Albania”. Fushata ka nisur në korrik 2020 dhe deri më 31 dhjetor 2023 janë publikuar dhe promovuar 260 produkte vendase në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të institucionit. Si pjesë e nismës për promovimin e produkteve “Made in Albania”, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve publikoi 4 katalogë të produkteve “Made in Albania” dhe gjithashtu një rubrikë të dedikuar në faqen e internetit. Linku i rubrikës: <https://aida.gov.al/made-in-albania/>

Gjatë vitit 2024, fushata u rikonceptua në krahasim me vitet e mëparshme. AIDA prodhoi 1 katalog me 59 produkte nga prodhues vendas duke përfshirë verën, birrën, bulmetin, reçelin, mjaltin, vajin e ullirit, glikos shqiptare etj. Për të nisur këtë fushatë, AIDA organizoi një event më 23 maj 2024. Ky event bashkoi prodhuesit vendas dhe hotelierët shqiptarë. Objektivi i eventit ishte të sillte prodhimet vendase në vëmendjen e hotelierëve dhe t'i inkurajonte ata të shërbenin në menutë e tyre produktet “Made in Albania”. Në këtë event, i pari i këtij lloji, morën pjesë Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë, të cilët shfrytëzuan këtë mundësi për të ripërforcuar vizionin e AIDA-s. Eventu u pasua nga një mini panair dhe një ngjarje e rrjeteve sociale, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të krijojnë lidhje domethënëse. AIDA parashikon që ky event të bëhet traditë çdo vit.

Link i katalogut: <https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Zgjidh-te-Vendit.pdf>

Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Një nga funksionet e AIDA-s është të mbështesë dhe lehtësojë pjesëmarrjen në panairët kombëtare dhe ndërkombëtare për NMVM-të shqiptare.

Panaire ku AIDA ka qënë pjesëmarrëse:

2021 (3 panaire)

1. ProSEED Expo
2. Shqipëria Punon Tokën – Shijo produktet lokale
3. Panairi Ndërkombëtar i Tiranës

2022 (5 panaire)

1. 'Ditët e Bujqësisë', Lushnjë;
2. Pjesëmarrje në panairin e bimëve medicinale dhe aromatike Biofach 2022, Nuremberg, Gjermani;
3. Pjesëmarrje me standë në "Panairin e Energjisë, Ndërtimit dhe Ekonomisë së gjelbër 2022" në Tiranë, Shqipëri;
4. Pjesëmarrje me standë në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës, në datat 1 – 4 dhjetor, organizuar nga Klik Expo Group;
5. Pjesëmarrje në aktivitetin: Ditët e Eksportit Organik 2022 (Online) – Shqipëri, Serbi, Ukrainë.

2023 (7 panaire)

1. Organizimi dhe pjesëmarrja në panairin "EXPO FOOD", në datat 18-20 Mars 2023, në Athinë, Greqi. AIDA mbështeti 5 kompani shqiptare të sektorit "Pije & Ushqim".
2. Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin "Ditët e Bujqësisë", në datat 27-29 Maj 2023, në Lushnjë.
3. Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin "MACFRUT 2023", në datat 03-05 Maj 2023, në Rimini, Itali. AIDA mbështeti 5 kompani shqiptare të sektorëve bimëve medicinale dhe fruta-perime. Për realizimin e panairit, AIDA bashkëpunoi me Swiss Import Promotion Programme (SIPPO) dhe projektin "Kukës New Perspective" të mbështetur nga Swiss Contact, me qëllim vazhdimin e misionit për promovimin e produkteve "Made in Albania" dhe gjetjen e tregjeve të reja.
4. Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin kombëtar "Food & Drinks" në datat 23-25 Maj 2023 në Tiranë, të organizuar nga EXPO CITY. AIDA mbështeti 10 kompani të sektorit të ushqimit dhe pijeve. Nën logon "Made in Albania", kompanitë pjesëmarrëse patën mundësinë të promovonin produktet e tyre dhe të takonin klientë dhe blerës, ku shkëmbyen dhe kontaktet për mundësi bashkëpunimi të mëtejshme. Në këtë panair gjithashtu, AIDA ishte pjesë e Forumit "Sfidat e Agropërpunuesve".
5. Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin ndërkombëtar "ISPO MUNICH", në datat 28-30 nëntor 2023, në Mynih, Gjermani. AIDA mbështeti 5 kompani të sektorit të veshjeve sportive. Ky panair u realizua në bashkëpunim me Swiss Import Promotion Programme Albania (SIPPO) dhe shoqatën Pro Export Albania.
6. Pjesëmarrja me standë në panairin Ndërkombëtar të Tiranës, në datat 4-7 dhjetor 2023, në pallatin e Kongreseve, organizuar nga Klik Ekspo Group.
7. Organizimi dhe pjesëmarrja me standë në panairin ndërkombëtar "BIOFACH 2024", në datat 13-16 Shkurt, në Nuremberg, Gjermani. AIDA mbështeti 6 kompani të sektorit të produkteve organike. Ky panair u realizua me mbështetjen e projektit Intracen (ITC-Trade Promotion East) dhe në bashkëpunim me Swiss Import Promotion Programme Albania (SIPPO).



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Gjatë vitit 2024, AIDA mori pjesë në panaireset e mëposhtme:

Panaire Kombëtare

- Panairi “Ditët e Bujqësisë” 27 – 29 Prill 2024, Lushnje, Shqipëri. AIDA mori pjesë me një stendë në Panairin Ditët e Bujqësisë 2024.
- “Agro Tech & Natural Expo”, Maj 2024, Tiranë. AIDA mori pjesë me një stendë në Panairin Agro Tech & Natural Expo, në kuadër të mbështetjes dhe promovimit të sektorit bujqësor dhe produkteve shqiptare, nëpërmjet informimit të palëve të interesuara, si dhe organizimit të takimeve për bashkëpunim dhe partneritet mes bizneseve pjesëmarrëse.

Panaireset Ndërkombëtare

“BIOFACH”, Panairi, 13-16 Shkurt 2024, Nuremberg, Gjermani. Gjashtë kompani nga sektorët e vajit të ullirit dhe bimëve mjekësore morën pjesë në panair, me stendën e organizuar nga AIDA dhe partnerë si SIPPO dhe ITC, Intracen Project (Tregtia Ndërkombëtare me logon “Made in Albania”. Shërbimet e ofruara nga AIDA në mbështetje të kompanive pjesëmarrëse ishin: “BIOFACH”, Panairi, 13-16 Shkurt 2024, Nuremberg, Gjermani. Gjashtë kompani nga sektorët e vajit të ullirit dhe bimëve mjekësore morën pjesë në panair, me stendën e organizuar nga AIDA dhe partnerë si SIPPO dhe ITC, Intracen Project (Tregtia Ndërkombëtare me logon “Made in Albania”. Shërbimet e ofruara nga AIDA në mbështetje të kompanive pjesëmarrëse ishin:

- Organizimi i seminarit online nga eksperti i SIPPO Albania, me informacion mbi tregun evropian, eksportet Shqipëri-Evropë-Itali.
- Promovimi, përgatitja dhe njohja me listën e blerësve të mundshëm në Itali dhe më gjerë.
- Asistencë në organizimin dhe organizimin e takimeve me blerësit potencial.
- Organizimi i vizitave në stendat e kompanive të sektorit të vajit të ullirit dhe bimëve mjekësore dhe aromatike.

Gjithashtu, AIDA, ITC dhe SIPPO organizuan vizita derë më derë në kompani gjatë datave 17-19 janar 2024. “MOMAD”, 13-15 shtator 2024, Madrid, Spanjë. Në panair morën pjesë 3 kompani nga sektorët e tekstileve dhe veshjeve të këmbëve, me stendë të organizuar nga AIDA dhe partnerë si SIPPO me logon “Made in Albania”. Shërbimet e ofruara nga AIDA në mbështetje të kompanive pjesëmarrëse ishin:

- Organizimi i seminarit online nga eksperti i SIPPO Albania, me informacion mbi tregun evropian, eksportet Shqipëri-Evropë-Itali.
- Promovimi, përgatitja dhe njohja me listën e blerësve të mundshëm në Itali dhe më gjerë.
- Asistencë në pritjen dhe organizimin e takimeve me blerësit potencial.
- Organizimi i vizitave në stendat e kompanive të sektorit të vajit të ullirit dhe bimëve mjekësore dhe aromatike.

Gjithashtu, AIDA dhe SIPPO organizuan vizita derë më derë në kompanitë gjatë datave 25-28 maj 2024.

Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2024, AIDA dhe partnerët organizojnë 2 panaire ndërkombëtare:

- “Global Albanian Gastronomy Festival”, 2-3 tetor 2024, Berlin, Gjermani
- “FI NORTH 2024”, 30-31 tetor 2024, Las Vegas, SHBA.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Programi i eksportit	Strategjia e eksportit e zhvilluar deri në vitin 2022	Në proces

1.1.6 Masa “Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë.

Progresi në zbatimin:

AIDA, ka publikuar guidën mbi tregtinë elektronike për NMVM, nëpërmjet udhëzuesit “Si të nisësh një Biznes e-commerce” si edhe punuar për ngritjen e kapaciteteve për e-commerce.

Plan veprimi e- commerce

Në 2024 është miratuar urdhri i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 397 datë 10.06.2024 “Për Miratimin e Strukturës së Planit të Veprimit për Tregtinë Elektronike 2024-2027”. Grupi i punës për zhvillimin e nismës “Zhvillimi i Tregtisë Elektronike”, me anëtarë përfaqësues edhe nga AIDA në bashkëpunim me Bankën Botërore, hartuan, publikuan dhe prezantuan Guidën “Si të nisësh një biznes e-commerce”, pyetësin “Self-Assessment Tool”, si dhe një seri trajnimesh të dedikuara specifikisht kësaj nisme – 2022.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.1.6.1: Krijimi i një faqe interneti informacioni (përfshirë udhëzuesit dhe mjetin e vetëvlerësimit për e-commerce).

Tregtia Elektronike (Ecommerce): Duke qenë se tregtia elektronike dhe biznesi elektronik janë bërë gjithnjë e më shumë të nevojshëm për strategjinë e biznesit dhe njëkohësisht një katalizator për zhvillimin ekonomik, AIDA, ka publikuar guidën mbi tregtinë elektronike për NMVM, nëpërmjet udhëzuesit “Si të nisësh një Biznes e-commerce”. Ky udhëzues përfaqëson një dokument orientues për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme, (NMVM-të), Start-up, si edhe çdo palë të interesuar në planifikimin, dizajnin dhe zhvillimin e tregtisë elektronike. <https://aida.gov.al/e-commerce.pdf>.

Grupi i punës për zhvillimin e nismës “Zhvillimi i Tregtisë Elektronike”, i përbërë nga AIDA në bashkëpunim me Bankën Botërore, hartuan, publikuan dhe prezantuan Guidën “Si të nisësh një biznes e-commerce”, pyetësin “Self-Assessment Tool”, si dhe një seri trajnimesh të dedikuara specifikisht kësaj nisme.

Gjatë takimit online u prezantua udhëzuesi “Si të nisësh një biznes e-commerce”, në ndihmë të sipërmarrjeve dhe palëve të interesuara në zhvillimin e tregtisë elektronike. Në takim ishin pjesë përfaqësues të AIDA-s, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës Botërore.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Aktiviteti 1.1.6.2: Zbatimi i masave për ngritjen e kapaciteteve (programe për e-commerce)

Gjatë periudhës Qershor – Korrik 2022 AIDA mori pjesë në 7 ciklet e trajnimeve të organizuar nga AIDA – AITA –BERZH në lidhje me tregtinë elektronike. AIDA ishte në rolin e bashkëorganizatorëve dhe trajnuesve për disa nga temat e trajtuara në ciklin e trajnimeve. Trajnimi përfshinte materiale teorike dhe ushtrime praktike (Qershor-Korrik 2022).

Aktiviteti 1.1.6.3: Webinare/trajnime mbi tregtinë elektronike

Në Tetor 2023, AIDA në bashkëpunim me Qendrën Aleanca Gjimore për Zhvillim (GADC) realizoi një trajnim mbi tregtinë elektronike për gratë sipërmarrëse, kryesisht artizane dhe gra të sektorit të mikëpritjes, hotel-eri-turizëm.

AIDA është pjesë e grupit kontribues në lidhje me hartimin e Planit të Punës së E-commerce për Shqipërinë 2023 – 2026 dhe ka qënë e pranishme në të gjitha mbledhjet e organizuara në funksion të draftimit të këtij dokumenti.

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Iniciativa e zhvillimit të biznesit elektronik	- 300 biznese përfituese (2022-2024) - 75 zgjidhje për biznesin elektronik/tregtinë elektronike të miratuara nga përfituesit - 15% rritje në eksportet e bizneseve nërfituesve	1 Guidë udhëzuese 7 cikle trajnimesh për përfituesit Miratimi i planit të veprimit nga MEKI

2. Objektivi specifik 1.2: “Zhvillimi i NMVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni”

1.2.1 Masa “Skema e mbështetjes së sipërmarrjes së bazuar në konkurrencë”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë.

Progresi në zbatimin:

Nëpërmjet PROSEED është mundur zbatimi i skemave të mbështetjes me trajnim dhe grante për sipërmarrjen.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.2.1.1: Zbatimi i një programi trajnimi dhe mentorimi për sipërmarrësit aspirues.

Projekti “CoSolve-19” i PROSEED mbështeti në 3 faza modelin e një biznesi të qëndrueshëm

- Trajnim dhe këshillim për NMVM-të është shtylla kryesore e programit
- Informim për aksesin në financë
- Grante për bizneset që nuk janë financuar nga burime të tjera të financiare

Të dhëna mbi mbështetjen e projektit:

- 703 pjesëmarrës gjithsej në trajnime (sektorët turizëm, bujqësi, te tjera)

Aktiviteti 1.2.1.2: Organizimi i konkurseve për promovimin e skemës/sipërmarrjes dhe përzgjedhja e përfituesve

Të dhëna mbi mbështetjen e projektit “CoSolve-19” i PROSEED :

- 43 % e pjesëmarrësve në CoSolve-19 përfituan grante (229 përfitues) në shumën rreth 7 000 euro secili Përfitimet e pjesëmarrësve nga mbështetja e projektit kanë qenë si vijon:
- Nga monitorimi i parë rezulton se mbështetja e dhënë ka patur efektet në punësim tek NMVM-të
- Efektet e punësimit arrihen më mirë me kombinimin e trajnimit dhe dhe granteve
- Fokusi në trajnim nxit ndryshimin e sjelljes së bizneseve

Aktiviteti 1.2.1.3: Krijimi i sektorit të ri të trajnimit në AIDA

Nuk është mundësuar

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Skema e mbështetjes së sipërmarrjes së bazuar në konkurrencë	- 360 NMVM që marrin pjesë në CoSolve-19 - 150 pjesëmarrës në trajnime çdo vit (të paktën 40% femra) - 30 grante çdo vit (të paktën 40% ndaj grave)	703 pjesëmarrës gjithsej në trajnime 229 përfitues (43 % e pjesëmarrësve përfituan grante)

1.2.1 Masa “Skema e mbështetjes së sipërmarrjes së bazuar në konkurrencë” 1.2.2 Masa “Forcimi i ekosistemit të startup-eve”

Institucioni udhëheqës: Ministri përgjegjës për ekonominë.

Institucion kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Mbështetjen e startup-eve, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, inkubatorët, përsheptuesit dhe organizatat e mbështetjes së mëtejshme.

Progresi në zbatim:

Krijimi dhe funksionimi i Agjencisë Start up Albania dhe zbatimi i projektit EU for Innovation.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.2.1.1: Zbatimi i një programi trajnimi dhe mentorimi për sipërmarrësit aspirues.

-Ndërtimi i bazës së një ekosistemi fillestar të qëndrueshëm: Krijimi i një Agjencie të dedikuar për Startup (“Startup Albania”) që lehtëson zhvillimin e ekosistemit formon një element qendror të këtij veprimi prioritar. Agjencia “Startup Albania”, është themeluar më dhjetor 2023, si një agjenci shtetërore në varësi të Ministrisë së Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit. Misioni i “Startup Albania” është të sigurojë mirëfunksionimin e ekosistemit të startup-eve zhvillimin e sipërmarrjes inovative nëpërmjet mbështetjes dhe zhvillimit të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Disa nga objektivat kryesorë janë menaxhimi dhe monitorimi i mbështetjes financiare përmes fondeve publike për sipërmarrjet inovative, krijimi i një one-stop shop-i për të mbështetur startup-et me anë të shërbimeve; promovimi i iniciativave në ekosistemin e sipërmarrjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; rritja e instrumentave të financimit për startup-et, si dhe rritja e kapaciteteve të aktorëve. Agjencia ka në strukturë prej 10 punonjësish dhe operon mbi strategjinë kombëtare të zhvillimit të sipërmarrjes inovative.

- Agjencia “Startup Albania”: Në total numri i startup-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik dhe të pajisur me pasaportën përkatëse që mënaxhohet nga Agjencia “Startup Albania” është rreth 2108 deri në fund të muajit Shtator 2024.
- Numri total i lehtësuesve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik dhe të pajisur me pasaportën përkatëse është 342.
- 2,108 startup-e të regjistruara, nga të cilat 793 janë ndërmarrë nga gra sipërmarrëse dhe 1,315 janë ndërmarrë nga burra sipërmarrës; 1,145 janë në fazën fillestare, 593 janë në fazën e rritjes dhe 370 janë në fazën e zgjerimit.
- 342 lehtësues të regjistruar, duke ofruar mbështetje përmes ndërhyrjeve horizontale në ekosistem.

Aktiviteti 1.2.2.2: Projekti i EU for Innovation

Projekti “EU for Innovation” ka realizuar aktivitetet si vijon:

Projekti ofron zhvillimin e kapaciteteve (Capacity building) që adreson ekosistemin e fillimit dhe inovacionit në qendër të vëmendjes. Aktorët dhe shërbimet ekzistuese tashmë janë forcuar për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme. Aktorët e rinj publikë dhe privatë inkurajohen të hyjnë në ekosistemin e start-up-eve dhe inovacionit shqiptar për të ofruar shërbimet e tyre.

Disa nisma/aktiviteteve të mbështetura nga projekti janë arritur si vijon:

- 177 biznese fillestare/sipërmarrëse, nga të cilët 76 janë të udhëhequr nga gratë kanë përfituar nga aktivitetet mbështetëse (p.sh., programe inkubimi dhe përsheptimi, trajnime dhe seminare të fokusuara në inovacionin) [vlera e synuar: 300];
- 15 start-up, nga të cilat 7 gra drejojnë, kanë përfunduar programin e gatishmërisë për investime/ gati për investime për të aplikuar për financim dhe/ose për të kërkuar investime [vlera e synuar: 30];
- Janë dorëzuar 8 programe mbështetëse me CD për bizneset start up; nga të cilat 3 programe përsheptimi (programi UPLIFT, CCL-Tirana, GrowPreneur -CCL Shkodra) dhe 5 programe inkubimi për start-up-et në fazat e hershme të fokusuara kryesisht në inovacionin, duke përfshirë edhe programet e inkubacionit (programi SEAM i Destil Creative Hub, Good Startup School, CITi ignite incubation programme, DigiSapiens, Tirana Inc.- programi i inkubacionit të lidhur me shumë universitete) [vlera e synuar: 9];
- Janë realizuar disa raporte këshillimi të politikave për politikëbërësit shqiptarë, të tilla si: Analiza e Kornizës Rregullatore për investimet fillestare në Shqipëri për Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit (MSHSKB), Strategjia e Specializimit Smart S3 për Qeverinë Shqiptare; Strategjia Shqiptare e Sipërmarrjes për MSHSKB, Mbështetje për zhvillimin e politikave për qytetin e Tiranës për Ekonominë Rrethore, etj. [vlera e synuar: 3];
- 70 nëpunës të administratës morën pjesë në seminare dhe trajnime, si: workshope – tryeza të rrumbullakëta në kuadër të zhvillimit të strategjisë S3, seminare të grupeve të interesit Horizon Europe & DEP, Kurs Trajnimi-Levat e Veprimit të Qytetit për Ekonominë Rrethore për Bashkinë e Tiranës, etj. [vlera e synuar: 40];
- 6 ISO-të shqiptare u mbështetën për një bashkëpunim afatgjatë me ISO/shoqata të huaja ISO të BE-së, si: UPLIFT – Sllovak aid, Tirana Inc-Preneurz. Amsterdam, Good Startup School - Koestinger Consulting (Au); Albania-Tech dhe Deelroom.com, Universiteti Polis dhe aleanca Bauhaus4EU, Growpreneur- Deep Ecosystems (Ger.). [vlera e synuar: 13].

• **Përmirësimi i aksesit në financa:** Ndërtimi i skemave ekzistuese/të mbështetura nga donatorët, p.sh. projekti “EU for Innovation” ky komponent parashikon futjen e instrumenteve të mëtejshme të financimit që plotësojnë sigurimin e granteve për fillestarët dhe organizatat mbështetëse. Zhvillimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit dhe baza ligjore për financimin e tyre.

Në Shkurt 2024, Agjencia “Startup Albania” hapi thirrjen për të aplikuar skemën e mbështetjes financiare prej 300 milionë lekësh për startup-et inovative. Thirrja për mbështetje të startup-ve 2024 është hartuar duke marrë parasysh nevoja të këtij komuniteti, si dhe eksperiencat e mëparshme të thirrjeve të implementuara nga buxheti i shtetit dhe donatorët që operojnë në vend. Fondi ishte i ndarë në tre kategori me financimin përkatës: Faza 1 - deri në 1,5 mln lekë. Financohen individë privatë, nomadët dixhitalë që kanë plane të ndërtojnë operacionet në Shqipëri; Faza 2 - deri në 4,5 mln lekë. Financohen kompani, të cilat tregojnë një prototip, bazë klientësh dhe potencial zhvillimi produkti/shërbimi; Faza 3 - deri në 9 mln lekë. Financohen kompani të regjistruara në regjistrin tregtar në Shqipëri, me një shërbim/prodakt funksional. Në total ishin 539 aplikime, prej të cilave kanë rezultuar 94 fitues. Përkatësisht, 23% e tyre i takojnë F1, 57% F2 dhe 19% F3.

• 94 projekte të financuara, nga të cilat 22 në Fazën 1 (faza e konceptimit), 54 në Fazën 2 (faza e validimit) dhe 18 në Fazën 3 (faza e zgjerimit dhe ndërkombëtarizimit).

• 29% e përfituesve të startup-eve janë vajza dhe gra.

• Mosha mesatare e startup-eve që morën pjesë në thirrje ishte 33.4 vjeç: 34.4 vjeç për gratë dhe 32.8 vjeç për burrat.

• Mosha mesatare e startup-eve të financuara në thirrje është 34.8 vjeç: 37.8 vjeç për gratë fituese dhe 33.5 vjeç për burrat.

• Shpërndarja e fondeve ishte 70% për kompanitë e themeluara nga burra ose një ekip i përbërë nga burra dhe 30% për kompanitë e themeluara ose të përbëra nga një ekip me 51% ose më shumë gra.

• Startup-et fituese ishin të shpërndara në disa industri dhe nënsektore:

• IT: 14 fitues

• AI, E-commerce: 10 fitues

• Prodhimi: 7 fitues

• EdTech, Health-Tech, Fintech: 6 fitues

• Energji, Turizëm, Shërbime Biznesi: 4 fitues

• AgTech: 3 fitues

• ESG, Kibernetikë, Robotikë, Ndërtim, Logjistikë, Ekonomia Rrethore: 2 fitues secila

• Modë, Media, Blockchain, Infrastrukturë, SportTech: 1 fitues secila

Shpërndarja gjeografike e fituesve:

• 84 në Tiranë

• 1 në Shkodër

• 1 në Vlorë

• 3 në Fier

• 2 në Korçë

• 2 në Lezhë

• 1 në Dibër

* Projekti “EU for Innovation”: Produkti 2 i projektit të “EU4Innovation” synon të përmirësojë aksesin në financa për start-up-et dhe ISO-të shqiptare. Si vazhdimësi e fondit sfidues të menaxhuar nga Sida gjatë fazës 1, skema e granteve synon (i) sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) / start-ups dhe (ii) start-ups me një përmbajtje të spikatur teknologjike, me potencialin për t’u bërë globale dhe për t’u rritur shpejt. Ai përfshin bizneset në të gjitha fazat e zhvillimit (ide, vërtetim, rritje, rritje).



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NJËTËS SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Aktivitetet e zgjedhura në fushat e crowdfunding, investitorëve engjëj dhe investimeve të kapitalit plotësojnë këtë qasje nga ana e GIZ.

Rezultatet kryesore të arritura nga zbatimi i projektit janë si vijon:

Në bashkëpunim me SIDA, projekti ka identifikuar, përzgjedhur dhe nënshkruar një marrëveshje me partnerin zbatues (Partneri Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim) që do të mbështesë zbatimin e aktiviteteve të “Challenge Fund”. Projekti ka nisur Thirrjen e Parë dhe të Dytë për Propozime të skemës së “Challenge Fund” në Nëntor 2023 dhe Prill 2024. Në total janë pranuar 396 aplikime nga start-ups dhe NMVM-të në 35 qytete të Shqipërisë.

- Janë mbyllur 2 thirrje për propozime. 20 startup dhe NMVM të financuara (nga 50)
- Paketa e aplikimit për skemën e “Challenge Fund” për mbështetjen e NMVM-ve/start-up-eve e përditësuar dhe platforma e aplikimit online CHF e përmirësuar.
- 1000 individë arritën që përmes 22 sesioneve informuese të organizuara në të gjithë Shqipërinë për të promovuar 2 thirrje për propozime, 2 spote televizive të përgatitura dhe prezantuara gjatë aktivitetit të lançimit dhe të transmetuara në kanalin YouTube të EU4Innovation dhe disa TV kombëtare si Top Channel, KLAN TV dhe RTSH.
- Ceremonia e ndarjes së çmimeve për fituesit e “Challenge Fund” së parë organizoi rreth 60 pjesëmarrës.
- Përfundoi trajnimi i 20 startup-ve fitues të “Challenge Fund” 1 mbi Të Bërit Biznes - Menaxhimi i Iniciativës së Sipërmarrjes. 20 startup të trajnuar (objektivi 50)
- 3 evente të organizuara për institucionalizimin e “Challenge Fund”-së brenda sistemit qeveritar (nga 10).
- Vlerësimi i fizibilitetit të procesit të dorëzimit të “Challenge Fund” tek institucioni shqiptar.
- ToRs për kryerjen e Raportit të Ekosistemit Start-up - Një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes aktuale të ekosistemit start-up në Shqipëri për vitin 2024 dhe renditja e vendit në nivel ndërkombëtar të përgatitur (1 i planifikuar).
- 3 evente të organizuara për dorëzimin e metodologjisë së Fondit të Sfidës së Inovacionit tek një institucion i përshtatshëm lokal (1 skemë do të krijohet).
- 2 ngjarje - MESBC, prezantimi i qasjes “Challenge Fund”, metodologjisë dhe procesit të vlerësimit.
- 1 event - MESBC për prezantimin e platformës online të aplikimit të fondit të Sfidës.
- 12 ISO, duke përfshirë 2 universitete, kanë marrë financim nëpërmjet procedurave të “thirrjes së hapur”, si Destil creative hub, DigitSapiens, Koestinger Tace & Partners, Yunus Social Business Fund, National Youth Kongres, Tirana Inc. dhe ALBICT-LS, INNOVET partnerët (Albacademy, ICLA, Junior Achievement Albania, Mirash Ivanaj Foundation) [vlëra e synuar: 10].
- Në fazë zbatimi: aktualisht 0 por 6 evente do të organizohen nga Business Angel Network-i i sapokrijuar (nga 6 plani).
- Në fazë zbatimi: funksion projekti pilot i crowdfunding i inkorporuar në një platformë shqiptare (nga 1 plani).
- **Nxitja dhe zbatimi i qasjes Quadra Helix:** Promovimi i lidhjeve midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit (institucionet e arsimit të lartë, industri, qeveri, shoqëri) formon një fokus tjetër të këtij veprimi prioritar që përfshin për shembull, një varg ngjarjesh dhe formatesh të rrjeteve. Për të zhbllokuar potencialet e sipërmarrjes, institucionet arsimore do të ndihmohen në përshtatjen e plan-programeve të tyre dhe forcimin e lidhjeve me komunitetin fillestar (p.sh. lidhjet e praktikave dhe “hackathonët” e studentëve).
- Agjencia “Startup Albania”: Një nga prioritetet është dhe nxitja e sipërmarrjes me burim shkencor, ku një nga nismat e ndërmarra është dhe komercializimi i kërkimit shkencor përmes aktiviteteve të përbashkëta mes akademisë, AKKSHI-së dhe agjencisë.
- Projekti “Eu for Innovation”: Projekti promovon dhe zbaton qasjen Quadruple Helix (QH) për të gjeneruar inovacion dhe rritje ekonomike. Grupi i synuar është i hapur edhe për brezat e rinj.

Aktivitetet përfshijnë projekte pilotët green në nivel komuniteti, rritjen e ndërgjegjësimit dhe programe të zhvillimit të aftësive, p.sh., përmes integritit progresiv të edukimit për sipërmarrjen në kurrikulat universitare. Projekti përgatiti skema mbështetëse për të përmirësuar pjesëmarrjen e aktorëve shqiptarë të QH në Programet Kuadër të BE-së (FP) si Horizon Europe (HE), Programi i Evropës Dixhitale (DEP) dhe programe të tjera të BE-së lidhur me inovacionin. Një shembull konkret i kësaj është bashkëpunimi i QH nën drejtimin e Bashkisë së Tiranës për zbatimin e Laboratorit të Qytetit Green në Tiranë gjatë vitit 2024. Si rezultat i disa nismave dhe aktiviteteve të mbështetura nga aksioni, që nga korriku 2024, janë arritur rezultatet e mëposhtme:

- 2521 sipërmarrës aspirantë, nga të cilët 823 gra (studente universitare, studente të shkollave të AFP-së dhe/ose të tjera) 185 janë gra, janë ndërgjegjësuar për sipërmarrjen/start-up, si 5 iniciativa INNOVET (risi në AAP), Connect IT, pjesëmarrës në hackathon në programet e inkubacionit, etj [vlera e synuar: 4000]. Te INNOVET është nxitur bashkëpunimi midis ofruesve publikë të AFP-së, universiteteve dhe OSHC-ve.
- 17 trajnime (p.sh. seminare S3 dhe tryeza tematike të palëve të interesuara, sesione ndërgjegjësimi të DEP dhe Horizon Europe, Ditët Demo të programeve të inkubacionit/përsheptimit, hackathon dhe sesione të angazhimit të palëve të interesuara) janë organizuar me pjesëmarrjen e palëve të interesuara të QH për të mbështetur inovacionin, [vlera e synuar 10].
- 12 NMVM/start-ups të CCL-Tirana po punojnë për të ofruar disa zgjidhje të gjelbra/dixhitale për sfidat e bashkive shqiptare (qyteti i Tiranës) me përfshirjen e të paktën tre aktorëve të QH [vlera e synuar: 12].
- 23 grupe/grupe studiuesish nga universitetet shqiptare kanë marrë mbështetje (seminare dhe trajnime) [vlera e synuar:12]
- 24 ISO/(përfshirë universitetet) shqiptare janë asistuar për të aplikuar për mbështetje për programet e Bashkimit lidhur me inovacionin dhe nisma të tjera të BE-së, duke përfshirë instrumentet rajonale të ndara sipas nën-sektorëve “të gjelbër/dixhital” [vlera e synuar: 20]
- 12 ISO/Start-up Shqiptarë kanë paraqitur aplikime të suksesshme për programet e Unionit të lidhura me inovacionin [vlera e synuar: 2]
- Do të krijohet së shpejti 1 qendër e komunitetit EIT (nga 1). Qendra e Komunitetit EIT në Shqipëri do të rrisë ndërgjegjësimin për aktivitetet e Komunitetit EIT, do të krijojë mundësi për inovatorët lokalë në të gjithë sektorët dhe do të angazhojë një numër në rritje të inovatorëve shqiptarë në aktivitetet e Komunitetit EIT.

• **Promovimi i Shqipërisë si një ekosistem fillestar dhe inovacioni:** Masat e synuara të komunikimit do të përdoren për të promovuar potencialet e sipërmarrjes / ekosistemit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

- Agjencia “Startup Albania”: Lidhur me këtë është nënshkruar një marrëveshje midis GIZ dhe LeSpot për të promovuar ekosistemin shqiptar të startup-eve me fokus në shtete si Gjermani, Austri dhe Itali, proces ky i cili do të organizohet me anë të orientimit e mbështetjes së agjencisë “Startup Albania”. Agjencia, gjithashtu, ka planifikuar aktivitete periodike dhe jo vetëm, si “Tirana Tech Meetup” e cila synon rritjen e kapaciteteve dhe aftësimin teknik të komunitetit të startup-eve.
- Nën siglën Tirana Tech Meetup janë organizuar 10 evente për priudhën Mars– Nëntor 2024, ku 10 folës ndërkombëtarë nga institucione si Microsoft, AWS, Zillow dhe Munich Tech University mbuluan tema të ndryshme me një pjesëmarrje prej 640+ themeluesish dhe profesionistësh.
- Agjencia ka zhvilluar dhe po zbaton një sërë aktiviteteve edukative që ofrojnë mbështetje për themeluesit dhe njohuri nga industria, të nevojshme për të zhvilluar zgjidhje që adresojnë probleme reale. Programi i parë u zhvillua në bashkëpunim me Frankfurt School of Finance, duke synuar të mbështesë themeluesit me aftësi për zhvillimin e biznesit, përgatitjen për investime dhe qasjen në fonde, me një pjesëmarrje prej 60 personash në dy trajnimet e realizuara në muajin Shtator dhe Tetor 2024. Këto trajnime do të zbatohen edhe gjatë periudhës Dhjetor 2024 – Qershor 2025.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

- Agjencia ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Drejtorinë e Pronësisë Industriale në Shqipëri, duke ofruar trajnim të përmuajshëm fizik dhe mbështetje ad-hoc nga personel i kualifikuar për trajtimin e vendimeve të lidhura me pronësinë, trademarks dhe dizajn industrial. Një mjet vetë-diagnostikimi i zhvilluar nga Drejtoria e Pronësisë Industriale me ndihmën e WIPO tani është i aksesueshëm falas nga çdo startup shqiptar. Në trajnim kanë marrë pjesë 45 persona.
- Projekti “Eu for Innovation”: Produkti 4 i EU4Innovation promovon Shqipërinë si një ekosistem fillestar dhe inovativ dhe destinacion për inovatorët dhe sipërmarrësit ndërkombëtarë dhe vendas. Projekti po punon për zbatimin e fushatave dhe aktiviteteve ndërgjegjëse për të promovuar aktorët kryesorë brenda ekosistemit, të cilët mund të shërbejnë si ambasadorë dhe modele. Projekti po përgatit skema mbështetëse për të përmirësuar pjesëmarrjen e aktorëve shqiptarë të QH në Programet Kuadër të BE-së (FP) si Horizon Europe (HE), Programi i Evropës Dixhitale (DEP), Diaspora Shqiptare për Edukimin e Sipërmarrjes dhe zhvillimin e ekosistemit fillestar. DIA-EEDU), programe të tjera të BE-së lidhur me inovacionin. Si rezultat janë mundësuar :
 - 546 artikuj/postime rreth ekosistemit shqiptar (p.sh., start-ups, sipërmarrësit, institucionet) të publikuara në mediat kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh., artikull lajmesh, podcast, media online) (nga 150 që duhen arritur).
 - Organizuar 82 evente të ekosistemit me mbështetjen e projektit (p.sh. seminare, takime, etj.) nga të cilat 18 ose 22% përfshijnë aktorë të industrisë (nga 150 që duhen arritur).

Ndërhyrjet të tjera janë në zhvillim dhe zbatim, duke synuar angazhimin dhe promovimin e më shumë aktorëve të ekosistemit të inovacionit shqiptar, në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Forcimi i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- funksionimi i Agjencisë së <i>startup</i>-eve - regjistruar 375 biznese <i>startup</i> inovative - shkalla e mbijetesës prej 65% pas 5 vitesh - 3,000 vende pune të krijuara nga bizneset <i>startup</i>	- Në projektin “Eu for Innovation” vlerësohet se pas 5 vitesh “survival rate” do të jetë 40% pas 5 vitesh. Vlerësimi bazohet në një studim të kryer me 386 biznese start-up që kanë marrë mbështetje gjatë fazës së parë të EU4I (2018-2022), nga të cilat 172 janë përgjigjur. - EU4I nuk monitoron “numrin e vendeve të reja të punës të krijuara” – nuk ka të dhëna të disponueshme

1.2.3 Masa “Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të startup-eve”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startupeve dhe Lehtësuesve (Startup Albania).

Institucioni kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, AIDA.

Progresi në zbatimin:

Janë kryer disa aktivitete për rritjen e iniciativës së mentorimit të diasporës.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.2.3.1: Rritja e iniciativës së mentorimit të diasporës (përfshirë rrjetet (virtuale) / ngjarjet e prezantimit).

Agjencia Startup Albania: Gjatë periudhës Qershor 2024 – Nëntor 2024, Agjencia Startup Albania ka ndërtuar një rrjet mentorësh të përbërë nga themelues dhe profesionistë të diasporës shqiptare. Në grupin e mentorëve bëjnë pjesë 38 profesionistë nga shtete të ndryshme, të cilët kanë realizuar mbi 24 sesione individuale mentorimi për industri dhe tematika të ndryshme si zhvillimi i biznesit, ndërkombëtarizimi dhe zhvillimi i teknologjisë. Rrjeti i mentorëve i ofrohet të gjitha kompanive startup, të cilat janë të regjistruara në regjistrin përkatës. Agjencia Startup Albania zhvillon një sesion mentorimi të hapur çdo muaj me një prej mentorëve në platformën LinkedIn dhe me një temë të përcaktuar. Sesioni i muajit Nëntor 2024 u zhvillua me Laert Bejtaj, themeluesin e startup-it Bricks.ai me bazë në Paris, Francë.

Gjatë fazës 1 të projektit “EU for Inovation”, si “partneritete për start-up-et me diasporën shqiptare” u zhvilluan takime (në formatin e mentorimit, transferimit të teknologjisë, partneriteteve, investimeve, etj) ndërmjet diasporës shqiptare dhe Start-up-it vendase. Këto partneritete rrisin shanset e Start-up-ve shqiptare për të pasur sukses dhe për të hyrë në tregjet ndërkombëtare. Ndërhyrja kryesore për këtë aktivitet është “Programi i Mentorimit Diapora” dhe që nga shtatori 2022, 14 biznese të reja shqiptare, si BTC, Altropost, Collective68, The Dancing Bits, PI SaaS, Miner.al, Shkolla Online. Ekipet e Tirana Inc., bashkëpunuan/përfituan nga mentorët e diasporës (ishin 19 mentorë të diasporës në raster).

Gjatë fazës 2 të projektit “EU4Innovation”, iniciativa “mentorimi i diasporës” është zgjeruar për të patur një qasje të strukturuar drejt “angazhimit të diasporës”. EU4I ka bashkëpunuar me Germin dhe ka ndërtuar një akses të fortë në komunitete të ndryshme të diasporës (si. p.sh. platformat e biznesit, organizatat sociale dhe kulturore, rrjetet studentore, etj.), duke u mundësuar atyre rilidhjen me vendlindjet në mënyrë më të strukturuar dhe më efikase duke promovuar një dialog të dyanshëm.

Bashkëpunimi ndërmjet EU4I dhe Germin synon:

- Shfrytëzimin e ekspertizës dhe njohuritë e studiuesve të diasporës për të krijuar 10 kurse novatore (përmirësimi i kurrikulave në programe të ndryshme studimi) që paraqesin dukshëm konceptet e sipërmarrjes dhe inovacionit, të përhapura në mënyrë ideale midis 10 Institucioneve të Arsimit të Lartë Shqiptar (IAL). Ai synon t'u ofrojë rreth 300 studentëve të regjistruar në këto kurse një kornizë të prekshme dhe pragmatike të botës reale, shoqëruar me udhëzime dhe mentorim të paçmuar që rrit përvojën arsimore dhe përgatit studentët për peizazhin gjithnjë në zhvillim të sipërmarrjes dhe inovacionit.
- Lidhjet ndërmjet 10 studiuesve të Diasporës dhe atyre në Shqipëri paraqesin një mundësi për forcimin dhe formalizimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të tyre (objektivi është formimi i konsorciumeve dhe aplikimi i përbashkët në programin Horizon Europe).
- Angazhimin e 20 profesionistëve të diasporës për të mentoruar bizneset e reja, sipërmarrësit aspirantë dhe aktorët e ekosistemit (në nismat e mbështetura nga EU4Innovation), duke aktivizuar ekspertizën e tyre për të udhëhequr dhe vlerësuar sipërmarrjet në zhvillim, për të ndarë njohuritë dhe aftësitë e tyre, duke ndihmuar në nxitjen e ndryshimeve me ndikim në peizazhin sipërmarrës të Shqipërisë.
- Mobilizimin e anëtarëve të diasporës për të promovuar ekosistemin e start-upeve dhe inovativ të Shqipërisë brenda dhe jashtë vendit. Anëtarë të shquar të diasporës ftohen të marrin rolin e “ambasadorëve të ekosistemeve” (novatorë dhe sipërmarrës, studiues) dhe të promovojnë ekosistemin përmes vendosjes së urave me ekosistemet ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Sipas “Iniciativës Rajonale të startup-eve”, ky aktivitet po punon drejt një nisme të quajtur projekti “The Ecosystem Connectors” që ndërton ura ndërmjet ekosistemeve evropiane të sipërmarrjes me synimin për të inkurajuar një integrim më të fortë ekonomik përmes lehtësimit të partneriteteve, ndarjes së njohurive dhe shkëmbimit të burimeve ndërmjet sipërmarrësve dhe burimeve, palët e interesuara. Edicioni i parë i projektit fokusohet në lidhjen e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Berlinit.

Nëpërmjet ngjarjeve të rregullta të rrjeteve, trajnimeve dhe punëtorive të dedikuara dhe udhëtimeve të shkëmbimit, projekti do t’u sigurojë sipërmarrësve në të gjithë Ballkanin Perëndimor akses në treg dhe mbështetje për zhvillimin e biznesit, si dhe akses në mundësitë për rritje ndërkombëtare.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Integrimi ndërkombëtar i ekosistemit të <i>startup</i> -eve	- 30 biznese <i>startup</i> shqiptare dhe 25 mentorë të diasporës që marrin pjesë - 12 organizata mbështetëse shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare - 25 biznese <i>startup</i> shqiptare që bashkëpunojnë me qendrat ndërkombëtare	- Që nga 24 korriku, të paktën 1 mentor i diasporës ka mbështetur 12 biznese fillestare shqiptare (Uplift), ndërsa nëpërmjet Germin EU4I do të angazhojë të paktën 30 studiues dhe profesionistë të tjerë të Diasporës për të mentoruar bizneset e reja shqiptare, sipërmarrësit aspirantë dhe aktorët e ekosistemit. - Që nga 24 korriku, 6 ISO shqiptare u mbështetën për një bashkëpunim afatgjatë me shoqata të huaja ISO/BE ISO, si: UPLIFT – Slaovak aid, Tirana Inc.-Preneurz.Amsterdam, Good Startup School - Koestinger Consulting (Au); Albania-Tech dhe Deelroom.com, Universiteti Polis dhe aleanca Bauhaus4EU, Groëpreneur-Deep Ecosystems (Ger.). [vlera e synuar: 13] - Nuk ka vlerë deri më 24 korrik. Vlera e synuar: 10 biznese fillestare/biznese për të bashkëpunuar me aktorë ndërkombëtarë (ref. te Ecosystem Connectors)

1.2.4 Masa “Nisma për ngritjen e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Institucioni kontribues: AIDA, ministri përgjegjës për ekonominë, MASR etj. dhe organizata të tjera mbështetëse.

Progresi në zbatimin:

AKKSHI po zbaton skemën që mundëson bashkëpunimin e universiteteve me biznesin.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.2.4.1: Grante për 20 konsorciume të përzgjedhura për të zhvilluar koncepte përmirësimi

Aktiviteti 1.2.4.2: Grante për 10 konsorciume të përzgjedhura për zbatimin e koncepteve të tyre të përmirësimit

Në zbatim të Ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”, AKKSHI si institucion që ka në fokus zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në përputhje me prioritet kombëtare, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet dhe sektorët e linjës, kontribuon në krijimin e infrastrukturës dhe instrumenteve të përshtatshme që zbatojnë politikën e kërkimit dhe zhvillimit në Shqipëri, duke promovuar aktivitete dhe sipërmarrje që zhvillojnë shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe duke luajtur një rol lider në krijimin e kulturës së kërkimit shkencor.

Një nga programet e financimit të AKKSHI është edhe programi për financimin e projekteve të teknologjisë dhe inovacionit (PTI). Ky program u mundësua nga AKKSHI për herë të parë në vitin 2023. Programi i dedikohet financimit të projekteve që vijnë si bashkëpunim mes universiteteve dhe biznesit.

Nëpërmjet këtij programi universiteteve dhe institucioneve kërkimore i jepet mundësia të aplikojnë nëpërmjet thirrjes së publikuar në faqen e AKKSHI. Afati për kohëzgjatjen e aplikimit përcaktohet në thirrje. Projektet propozimet e paraqitura vlerësohen nga komisionet e vlerësimit të gjashtë fushave prioritare të kërkimit shkencor në vend. Në përfundim të këtij procesi, financohen projektet fituese me vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI.

Projektet me kohëzgjatje dy vjeçare, synojnë zhvillimin e një produkti, procesi apo shërbimi të ri inovativ, të biznesit ose përmirësime të dukshme të tyre, duke u mbështetur në bashkëpunimin me komunitetin e kërkimit shkencor në vend.

Programi i AKKSHI i dedikuar projekteve të bashkëpunimit të komunitetit të kërkimit shkencor me biznesin është një program i cili do të vazhdojë të nxisi bashkëpunimin midis tyre. Në vitin 2024 buxheti i shtetit i dedikuar këtij programi u rrit me tre herë krahasuar me vitin 2023.

Në grupet e punës të realizimit të 10 projekteve të bashkëpunimit me biznesin të financuara nga AKKSHI për vitin 2023, 53 % e tyre janë gra.

Në kuadër të këtij programi (programit të bashkëpunimit mes universiteteve dhe biznesit) AKKSHI në vitin 2023 ka financuar 10 projekte me një vlerë totale prej 17,960,000 lekë. Në vitin 2024 u financuan 18 projekte me vlerë 43,714,434 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Nisma për ngritjen e zinxhirit të vlerës së bazuar në konkurrencë	- 40 aplikime/20 konsorciume të zgjedhura për fazën e konceptit më 2022 - 10 konsorciume të mbështetura në fazën e zbatimit 2023-2024 - 15% rritje në të ardhurat e NMVM-ve pjesëmarrëse në vitet 2023 dhe 2027 - 50 vende të reja pune të krijuara nga përfituesit deri më 2023 dhe 2027	- 10 projekteve të bashkëpunimit me biznesin të financuara nga AKKSHI për vitin 2023. 53 % e tyre janë gra. - Në vitin 2024 u financuan 18 projekte me vlerë 43,714,434 lekë.

1.2.5 Masa “Rritja e aksesit në financë”

Institucioni udhëheqës: Ministri përgjegjës për ekonominë.

Institucioni kontribues: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Progresi në zbatimin:

Krijimi i bazës ligjore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme si edhe financimi i tyre.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.2.5.1: Krijimi i portalit të NMVM-ve për aksesin në financa

Platforma “Akses në Financë”: Platforma “Akses në Financë” është krijuar për t’u shërbyer Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme shqiptare, të cilat duan të zgjerojnë dhe investojnë në aktivitetin e tyre duke përfituar nga mundësitë financiare që tregu ofron, me grante, kredi apo nisma të tjera financuese. Kjo platformë online ofron një shërbim “one-stop-shop” me informacione që lidhen drejtpërdrejt me aksesin në financë për NMVM-të, i cili ofrohet nga institucione, organizata apo kompani të ndryshme private dhe publike, kombëtare e ndërkombëtare.

AIDA, si zbatuesja kryesore e kësaj nisme, ka ndjekur, asistuar dhe dhënë një kontribut të vazhdueshëm gjatë krijimit të platformës, në bashkëpunim me kompaninë e saj të zhvillimit.

AIDA në vazhdimësi ka mbledhur komente të rëndësishme për performancën dhe përdorimin e platformës, si dhe ka prodhuar rekomandime për t’i shërbyer më mirë komunitetit të biznesit. Gjatë vitit 2023, platforma u pasurua me funksionalitete të reja që përfshijnë:

- Një ndarje e qartë ndërmjet granteve dhe “skemave të tjera financimi”.
- Një hapësirë e dedikuar për ekspertët ku aplikantët mund të gjejnë lehtësisht dhe të kontaktojnë ekspertin që u nevojitet.
- Një hapësirë e dedikuar për dëshmitë e suksesit.
- Një hapësirë e dedikuar për komente/sugjerime.

Statistikat e platformës: Platforma përditësohet në baza javore dhe publikohen mesatarisht 2-3 thirrje në muaj. Përgjithësisht, thirrjet që lidhen me digjitalizimin, inovacionin, teknologjinë dhe arsimin janë më të vizituara. Deri më 16 shtator 2024, në platformë janë publikuar 131 thirrje për aplikim, ndërsa faqja kryesore e internetit është vizituar gjithsej 259.959 herë.

Përdoruesit më të shpeshtë vijnë nga Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia, Anglia, Zvicra, Franca dhe Kosova. Mosha mbizotëruese e përdoruesve është 25-34 vjeç (33,5%) dhe 18-24 vjeç (27,5%). Nuk ka hendek të konsiderueshëm për sa i përket gjinisë, ku 54.15% e përdoruesve janë meshkuj dhe 45.85% femra.

Aktiviteti 1.2.5.2: Miratimi i ligjit për NMVM-të

Në periudhën 2020-2021, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik hartoi projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, për të adresuar dy probleme kryesore:

1. Ekzistencën e boshllëkut ligjor për dhënien e fondeve nga AIDA për bizneset;
2. Rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Që prej vitit 2019, Ministria e Drejtësisë ishte shprehur kundër miratimit të projektvendimit të KM për zbatimin e Fondit të Konkurrueshmërisë. Konkretisht dispozitat e referuara në projekt-akt nuk autorizojnë shprehimisht Këshillin e Ministrave për të nxjerrë një projektvendim me përmbajtje të tillë.

Gjithashtu janë përcjellë disa problematika në takimet e nënkomiteteve me Komisionin Evropian, Programit të Reformave Ekonomike si edhe raportet e OECD, si vijon:

- Sigurimin e shërbimeve mbështetëse për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për t'i ndihmuar bizneset të rriten, investojnë, përtërijnë, dixhitalizojnë dhe eksportojnë;
- Ofrimin e trajnimeve në përputhje me nevojat për investime të NMVM-ve;
- Vendorsjen e mekanizmave efektiv dhe transparent për të mbështetur ndërmarrjet e prekura nga kriza, në veçanti ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe të vetëpunësuarit;
- Sigurimin e transparencës duke konsultuar legjislacionin e ri me ndërmarrjet dhe partnerët socialë dhe konsultim i drejtpërdrejtë midis autoriteteve shtetërore dhe NMVM-ve;
- Përmirësimin e përthithjes nga NMVM-të e shërbimeve të mbështetjes për bizneset, duke ridizenjuar skemat ekzistuese dhe mbi bazën e fakteve dhe të dhënave statistikore;
- Zhvillimin e një strategjie të veçantë shoqëruar me planin e veprimit për zhvillimin e NMVM-ve;
- Hartimin e masave specifike për NMVM-të nga organeve të qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetqeverisjes vendore;
- Vlerësimin e politikave mbështetëse për NMVM-të dhe zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit të Aktit për Ndërmarrjet të Vogla.

Sa më lart, pas ndjekjes së procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit u mundësua miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit Nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, i cili parashikon:



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

1. Vendosjen dhe zbatimin e përkufizimit ligjor për NMVM-të

Përkufizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme sipas kriterit të xhiros/pasqyrave financiare dhe numrit të punësuarve nuk ndryshon sipas ligjit ekzistues. Me qëllim përkufizimin e një ndërmarrje si mikro, e vogël apo e mesme është parashikuar që me Udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë do të detajohet mënyra e deklarimit të llojit të ndërmarrjes nëse ajo është e pavarur, partnere apo e lidhur.

2. Vendosjen e formave të mbështetjes shtetërore për NMVM-të, duke përfshirë kryesisht:

- Mbështetje financiare nga buxheti i shtetit
- Mbështetje financiare nga donatorët vendas apo të huaj ;
- Garanci shtetërore të huasë sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik si dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave;
- Shërbime publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, sipas përcaktimeve në këtë ligj;

3. Vendosjen e rregullave për hartimin e skemës së garancive shtetërore të huasë

Projektligji parashikon që në rastet kur, për të mbështetur kreditimin e ndërmarrjeve, në zbatim të politikave të veçanta të Qeverisë, vendoset të lëshohet garanci shtetërore, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton fondin, sektorët, kushtet dhe kriteret, për garantimin e huasë për mbështetjen e ndërmarrjeve, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për ekonominë.

4. Ofrimin e shërbimeve publike nga Agjensia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve që përfshijnë kryesisht:

- Sigurimin e informacionit, këshillimit, zhvillimit të biznesit, trajnimit, zhvillimit profesional apo ritrajnimit, dhënien e shërbimeve metodologjike për ndërmarrjet si edhe personave fizikë që synojnë të krijojnë një ndërmarrje;
- Çdo informacion tjetër për mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve.

5. Përcaktimin e qartë dhe të plotë të organeve kompetente dhe detyrave përkatëse.

Projektligji propozon që autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme janë edhe njësitë e tjera të qeverisjes qendrore dhe vetqeverisjes vendore, të cilat në kuadër të hartimit të politikave të zhvillimit ofrojnë mbështetje për ndërmarrjet. Gjithashtu është parashikuar ngritja dhe funksionimi i Këshillit Konsultativ për Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, që do të ketë si kompetencë:

- diskutojë çështjet që lidhen me mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit;
- nxiti bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të biznesit/organizatave që mbështesin biznesin dhe organeve shtetërore;
- këshillojë lidhur me mënyrën e hartimit të skemave mbështetëse për biznesin.

6. Përfshirjen e mbështetjes që akordohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe organeve të tjera qëndrore shtetërore për NMVM-të dhe përmbledhjen e gjithë informacionit për mbështetjen e NMVM-ve .

Projektligji propozon që me kërkesë të AIDA çdo institucion raporton një informacion mbi nivelin e mbështetjes së dhënë për NMVM-te, dhe më pas AIDA harton një raport përmbledhës për skemat mbështetëse për biznesin. Ky proces i paraprin hartimit të skemave mbështetëse për biznesin nga ana e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, mbi bazën e fakteve dhe të dhënave statistikore për të orientuar mbështetjen e re për ato biznese dhe sektorë që kanë nevojën më të madhe dhe mënjeluar mbivendosjen e skemave për biznesin.

7. Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve

Projektligji parashikon që me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë, Këshilli i Ministrave miraton Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve së bashku me planin e veprimit. Strategjia do të përcaktojë vizionin, objektivat dhe përparësitë e promovimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve dhe rolin e njërive të qeverisjes qëndrore dhe vetëqeverisjes për zbatimin e Strategjisë. Gjithashtu projektligji parashikon fushat kryesore të mbështetjes dhe burimet e financimit.

Aktiviteti 1.2.5.3: Skema e granteve nga buxheti i shtetit

Grante AIDA për NMVM-te: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve hapi thirrjet për Grante në datën 12 Korrik, pas miratimit nga Ministri Përgjegjës për Ekonominë. Grante për mbështetje dhe zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për vitin 2024. Thirrja për projekt-propozimet do të qëndrojë e hapur 30 ditë kalendarike nga data e publikimit. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, pas mbylljes të thirrjes për Grante, për mbështetje dhe zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për vitin 2024, është në proces vlerësim të aplikimeve nga Njësia për Menaxhimin e Grantit. Pritet mbledhja e Bordit në zbatim të Urdhërit nr.496, datë 10.07.2024 të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Për emërimin e Anëtarëve të Bordit Vlerësues të Kërkesave për Dhënien e Granteve” për zbatim të VKM nr.407, datë 19.06.2024 dhe VKM nr.408, datë 19.06.2024.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Rritja e aksesit në financë	- 60 përfitues të Fondit të Zhvillimit të NMVM-ve çdo vit (2022-2027) - 30% përfitues e sipërmarrëse gra/biznese të drejtuara nga gratë (2022-2027) - 180 vende pune të reja të krijuara nga përfituesit e Fondit çdo vit (2022-2027) - hartuar një kornizë ligjore dhe nënligjore për NMVM-të (deri më 2021) - VKM për skemën e garancisë shtetërore e hartuar (deri në vitin 2023) - hartuar korniza ligjore për financimin e investimeve <i>crowdfunding</i> - krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit	- Realizuar skema e garancisë shtetërore për manufakturën - VKM për financimin e biznesit - Portali aksesit në financë

1.2.6 Masa “Programi i aftësive të ndërmarrjeve për NMVM-të”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucioni kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe shoqatat e biznesit

Progresi në zbatimin:

AIDA ka organizuar aktivitete për aftësitë e ndërmarrjeve.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.2.6.1: Koordinimi i programit të aftësive sipërmarrëse për NMVM-të

Projekte të Zbatuara

2021: AIDA ka qenë partnere në projektin Sfida IDEA duke asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, që prej promovimit, vlerësimit të planeve të biznesit dhe shpallja e finalistëve. Gjatë vitit 2021, rreth 300 start-upe inovative morën iniciativën për të forcuar kompetencat e tyre sipërmarrëse dhe aftësitë e biznesit, nëpërmjet gjenerimit të ideve dhe zhvillimit të planeve bindëse të biznesit

2022: AIDA ka qenë partnere në projektin Beyond IDEA duke asistuar në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, që prej promovimit, vlerësimit të planeve të biznesit dhe shpallja e finalistëve. Gjatë vitit 2022, 15 startupe inovative u kualifikuan si finalistë për iniciativat e tyre për të forcuar kompetencat sipërmarrëse dhe aftësitë e biznesit, nëpërmjet gjenerimit të ideve dhe zhvillimit të planeve bindëse të biznesit.

2023 : Projekti “Skills for Sustainable Employment and Inclusive Economic Growth of Cross-Border Region of Albania and Montenegro – Skills for Jobs Albania – Montenegro” është projekt i financuar nga Bashkimi Europian nga programi “Cross-Border Cooperation Programme Montenegro – Albania 2014-2020, nëpërmjet Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II).

Implementimi i këtij projekti ka filluar në Shkurt 2023 dhe do të zgjasë deri në Janar 2025.

Palët implementuese të projektit janë: Organizata jo-fitimprurëse në Mal të Zi, Foundation Business Start-Up Centre Bar (partner drejtues/koordinator), Dhoma e Ekonomike e Malit të Zi (partner), Agjencia Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (partner) dhe organizata jo-fitimprurëse e bazuar në qytetin e Shkodrës “Go2 Albania Organization” (partner i asociuar).

Qëllimi kryesor i këtij projekti është nxitja e punësimit dhe përfshirja sociale duke lehtësuar hyrjen në tregun e punës për të rinjtë dhe gratë në zonat ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Target-grupi i synuar përfshin punëkërkuesit me nivel të ulët dhe të mesëm arsimimi, nivel të ulët kualifikimi dhe me aftësi që nuk përputhen me kërkesën e tregut të punës, të rinjtë (mosha 15 deri në 29 vjeç) dhe gratë që kërkojnë punësim.

AIDA është pika kryesore e të gjitha aktiviteteve që do të zhvillohen në Shqipëri, që nga identifikimi dhe koordinimi i pjesëmarrësve në trajnim dhe mentorim, si dhe punëdhënësve dhe bizneseve që do të përfshihen në këtë projekt.

Aktivitetet e përfshira në implementimin e këtij projekti do të realizohen mes Shqipërisë (Bashkia Shkodër, Bashkia e Vaut të Dejës, Bashkia e Malësisë së Madhe) dhe Malit të Zi (Podgoricë, Tuz, Budva, Bar, Ulqin, Danilovgrad dhe Cetinje).

Tryeza të rrumbullakta

AIDA ka zhvilluar 4 tryeza të rrumbullakëta me temë “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorëve: “Bimë Medicinale dhe Aromatike”, “Pije dhe Ushqim”, “Tekstile dhe Lëkurë-Këpucë” dhe “Fruta-Perime”.

Zhvillimi i këtyre tryezave kishte në fokus nxitjen, përfshirjen e aktorëve dhe përfaqësuesve të bizneseve të këtyre sektorëve për identifikimin e nevojave, problematikave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve dhe adresimin e rekomandimeve të institucionet përkatëse.

1. Tryeza e rrumbullakët “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit të bimëve medicinale dhe aromatike” Tryeza mbledhi bashkë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shoqata e Bimëve Medicinale dhe Aromatike, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, GIZ Albania, Risi Albania, SIPPO Albania, Bioinspeksioni, Organic Trade for Development, si dhe kompani prodhuese të këtij sektori.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth nevojave të sektorit të bimëve medicinale dhe aromatike, përmirësimit të zinxhirit të vlerës për rritjen e konkurrueshmërisë, sfidat e prodhimit, menaxhimit të cilësisë, mbështetjen e fermerëve përmes shpërndarjes së informacionit dhe transferimit të dijeve, ofrimit të trajnimeve, mbështetjes financiare përmes dhënies së granteve, fondeve dhe projekteve, certifikimit të produkteve, certifikimit të disa fermerëve së bashku, inovacionit, promovimit të eksporteve, si dhe pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare.

Gjithashtu, u sugjeruan ide me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin mes palëve dhe të gjithë aktorëve të ekosistemit, në mënyrë që përfitimet që ky sektor sjell të jenë sa më funksionale dhe në dobi të të gjithë palëve.

2. Tryeza e rrumbullakët “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit pije dhe ushqim”.

Tryeza mbledhi bashkë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, Shoqata e Vajit të Ullirit, SIPPO Albania, Shoqata e Verërave Shqiptare, ekspertë të fushës, si dhe kompani prodhuese të këtij sektori.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth nevojave të sektorit pije dhe ushqim, përmirësimit të sigurisë ushqimore, në të gjitha hallkat e tij, strategji për pikat e grumbullimit sipas standardeve dhe parametrave të BE-së, inovacionit në ushqim, promovimit të produkteve “Made in Albania”, si dhe pjesëmarrjen në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë aktivitetit u dhanë sugjerime me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin mes palëve dhe të gjithë aktorëve të ekosistemit, në mënyrë që përfitimet që ky sektor sjell të jenë sa më funksionale dhe në dobi të të gjithë palëve.

3. Tryeza e rrumbullakët “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit “Tekstil dhe Lëkurë – Këpucë”.

Tryeza mbledhi bashkë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shoqata Pro-Eksport Albania, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Departamenti i Tekstilit dhe Modës në Universitetin Politeknik të Tiranës, Expo City Albania, SIPPO Albania, Swisscontact, ekspertë të fushës, si dhe biznese të këtij sektori.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth nevojave të industrisë së Tekstil & Lëkurë – Këpucë, që lidhen kryesisht me trajnimet, certifikimet e produkteve, dedikimin e një fondi të veçantë për mbulimin e problematikave aktuale, si edhe promovimin e kësaj industrie.

Gjatë aktivitetit u parashtruan edhe sfidat aktuale që kjo industri po ndesh gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj si: zhvlerësimi i euros, aksesit në financë, fuqia punëtore e kualifikuar, inovacioni, fleksibiliteti për përshtatje në një treg të ri dhe të tjera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SËI BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

INDEKSI GLOBAL I INOVACIONIT

4. Tryeza e rrumbullakët “Sfidat dhe identifikimi i nevojave të sektorit të Fruta Perime”.

Tryeza mbledhi bashkë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, GIZ Albania, Risi Albania, Creative Business Solution (CBS), Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), SIPPO Albania, Qendra Ndërkombëtare e Tregtisë në Shqipëri (ITC), Bioinspecta si dhe përfaqësues të bizneseve të këtij sektori.

Pjesëmarrësit diskutuan rreth nevojave të sektorit, që lidhen me bashkëpunimin midis aktorëve dhe grupeve të interesit, grupimin kolektiv të fermerëve, sigurimin e cilësisë dhe standarteve të produkteve, mekanizimin e mjeteve, ndërgjegjësimin për certifikimet sigurimin e kreditimit të eksporteve, rritjen e eksporteve të produkteve të fruta-perimeve, dedikimin e granteve për mbështetjen e këtij sektori, promovimin e kompanive të këtij sektori për pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.

Aktiviteti 1.2.6.2: Zbatimi i trajnimeve për NMVM-të

Trajnime të organizuara nga AIDA

1. Në kuadër të projektit: “Fuqizimi Ekonomik i Grave dhe perspektiva gjinore në zinxhirin e vlerave të biznesit”, i mbështetur nga Gender Equity and Equality Action (GEEA) i Departamentit të Shtetit, AIDA në bashkëpunim me Qendren Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), organizoi në ambientet e saj, trajnimin me temë “Brilliant Entrepreneurus”, në mbështetje të grave sipërmarrëse – 2023.
2. Grupi i punës për zhvillimin e nismës “Zhvillimi i Tregtisë Elektronike”, i përbërë nga AIDA në bashkëpunim me Bankën Botërore, hartuan, publikuan dhe prezantuan Guidën “Si të nisësh një biznes e-commerce”, pyetësorin “Self-Assessment Tool”, si dhe një seri trajnimesh të dedikuara specifikisht kësaj nisme – 2022.
3. Në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (AITA) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), AIDA organizoi një sërë trajnimesh me fokus tregtinë elektronike për NMVM-të shqiptare. Trajnimi përfshinte materiale teorike dhe ushtrime praktike (Qershor-Korrik 2022).
4. AIDA organizoi një seminar trajnimi të fokusuar në tregtinë elektronike në bashkëpunim me Qendrën e Aleancës Gjinore për Zhvillim (GADC), me mbështetjen e Gender Equity and Equality Action (GEEA). Ky trajnim targetonte gra artizanale dhe gra që punojnë në sektorin e turizmit dhe hotelerisë që synojnë të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre për të krijuar dhe menaxhuar një kanal e-commerce për biznesin e tyre.

Në 2023 AIDA ka koordinuar një seri trajnimesh në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për punësim të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike gjithëpërfshirëse të rajonit ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi - Financuar nga IPA II), të cilat targetojnë të rinjtë dhe gratë e papuna në zonën ndërkufitare Shqipëri-Mal i Zi, për të fituar njohuri teorike dhe praktike duke marrë pjesë në praktika punësimi pranë bizneseve lokale që operojnë në sektorin e turizmit, artizanatit dhe ICT.

RAPORT MONITORIMI 2021-2024



Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Programi i aftësive të ndërmarrjeve për NMVM-të	- 12 trajnime çdo vit. - 300 pjesëmarrës në trajnime çdo vit.	-4 tryeza të rumbullakëta -4 trajnime individuale me 105 pjesëmarrës

3. Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i kapitalit njerëzor

1.3.1 Masa “Skema e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucioni kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe shoqatat e biznesit.

Progresi në zbatimin:

Nuk ka patur aktivitete për skemën e mbështetjes për zhvillimin e kapitalit njerëzor bashkëpunues.

Përmbledhje

Nuk ka të dhëna mbi zbatimin e këtij aktivitetit.

-**Aktiviteti 1.3.1.1:** Ofrimi i subvencioneve për NMVM-të (pagat) dhe universitetet (mbikëqyrja dhe pajisjet)

-**Aktiviteti 1.3.1.2:** Koordinimi i skemës

-**Aktiviteti 1.3.1.3:** Ofrimi i subvencioneve për NMVM-të (pagat) dhe universitetet (mbikëqyrja dhe pajisjet)

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi 2021-2024
Skema e mbështetjes për zhvillimin bashkëpunues të kapitalit njerëzor	- 150 përfitues (të paktën 40% gra) - 100 NMVM që punësojnë studentë dhe kandidatë PhD	Na



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

1.3.2 Masa “Programi i zhvillimit të forcës së punës për dhe me NMVM-të dhe investorët”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Shqiptare e Investimeve e Investimeve (AIDA)

Institucioni kontribues: Ministri përgjegjës për ekonominë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë dhe shoqatat e biznesit.

Progresi në zbatimin:

Aktivitetet për programin e zhvillimit të forcës së punës për dhe me NMVM-të dhe investorët.

- Aktiviteti 1.3.2.1: Nënshkrimi i MOU
- Aktiviteti 1.3.2.2: Studim fizibiliteti për një qendër të zhvillimit të aftësive PPP

Këto aktivitete janë parashikuar në periudhën 2025-2027

1.3.3 Masa “Sistemi i parashikimit të nevojave të aftësive”

Institucioni udhëheqës: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit

Institucioni kontribues: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, ministri përgjegjës për ekonominë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, shoqatat e biznesit, dhe sektori privat.

Progresi në zbatimin:

AKPA po ndjek punën për krijimin e sistemit të parashikimit të nevojave të aftësive.

Përmbledhje

Aktiviteti 1.3.3.1: Zhvillimi i sistemit të parashikimit dhe një vlerësim pilot

Instrumenti i matjes dhe parashikimit të nevojave për aftësi/fuqi punëtore: Krahas dokumentave tradicional të tregut të punës si Buletini Statistikor apo Gjurmimet mbi të diplomuarit e certifikuarit të AFP, të cilët japin sinjale dhe indicie të rëndësishme mbi dinamikën dhe nevojat e tregut të punës, AKPA ka vijuar punën për ndërtimin e një instrumenti të dedikuar për parashikimin e nevojave për aftësi.

Për planifikimin e nevojave për aftësi për periudhën afatshkurtër deri afatmesme, AKPA është duke u mbështetur nga projekti “RECONOMY”. Ky instrument synon parashikimin e nevojave për aftësi nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të përcjella nga bizneset (+5 punonjës) nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar. Gjatë 6 muajve të parë të vitit 2024 janë zhvilluar takime rakorduese me projektin, janë diskutuar proceset/metodologjitë që përdoren aktualisht nga shërbimi kombëtar i punësimit në Lituani dhe Suedi si dhe validuar draft instrumentet që do të përdoren nga AKPA si metodologjia, pyetësori apo proceset organizative.

Analiza e Nevojave për Aftësi (SNA)

Në të njëjtën kohë në bashkëpunim me UNDP është iniciuar procesi i vlerësimit të nevojave afatmesme, i cili kryhet nëpërmjet Analizës së Nevojave për Aftësi (SNA). Ky instrument vlerëson në mënyrë gjithëpërfshirëse dinamikën e tregut të punës dhe identifikon tendencat dhe nevojat e sektorëve për fuqi punëtore. Gjatë 6 muajve të dytë 2024 pritet të nisë procesi i Analizës së nevojave për Aftësi.

Analizat rajonale të tregut të punës të kryera nga AKPA

Për periudhën afatshkurtër ka vijuar procesi i nisur në vitin 2023 për ndërtimin e analizave rajonale të tregut të punës, bazuar kryesisht në të dhënat administrative të AKPA, të dhënat cilësore të gjurmimeve dhe të dhënat e tregut të punës të gjeneruara nga INSTAT. Më specifikisht analizat marrin në konsideratë numrin e VLP-ve të shpallura në sistemin e shërbimeve të punësimit sipas profesioneve për secilën nga 9 kategoritë profesionale, numrin e nxënësve dhe kursantëve në VET të zërthyer sipas profesioneve për secilën nga 9 kategoritë profesionale, rezultatet e përputhjes së kërkesës (VLP) dhe ofertës së AFP sipas profesioneve dhe nivelet e punësueshmërisë së kurseve/ drejtimeve të shkollave/ programeve të nxitjes së punësimit të dala nga rezultatet e gjurmimeve. Ato kryesisht shërbejnë për të orientuar dhe përditësuar ofertën e AFP dhe identifikimin e mospërputhjeve. Gjatë 6 muorit të parë 2024 u ndërtuan 12 analizat dhe u organizuan nga AKPA 12 takime rajonale me prezencën e gjithë aktorëve rajonalë të tregut të punës si zyrtarë e punës, qendrat e formimit profesional, shkollat e mesme profesionale, bizneset, Këshilli i Qarkut, Bashkë, organizatat joqeveritare, me tematikë “Tryeza për partneritet rajonal në fushën e punësimit dhe aftësive”.

Gjatë vitit 2023 janë ndërtuar dhe ndarë me aktorët e tregut të punës 4 analiza rajonale (sipas ndarjes në 4 rajone kryesore).

Gjatë vitit 2024 janë ndërtuar dhe ndarë me aktorët e tregut të punës 12 analiza rajonale (për 12 qarqet).

Gjurmimi i të diplomuarve dhe certifikuarve të sistemit të AFP si një element matës për vlerësimin efikasitetit të politikave/programeve dhe përthithjen e sinjaleve të tregut të punës.

Drejtorja e Performancës dhe Informacionit të Tregut të Punës në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të AFP-së dhe me mbështetjen e projektit “Skills 4 Jobs” në mënyrë të përvitshme zhvillojnë gjurmimin në nivel kombëtar të diplomuarve nga shkollat e mesme profesionale dhe të certifikuarve nga QFP-të. Ky proces zhvillohet në formë censusi ku të diplomuarit pyeten nëpërmjet kontaktit telefonik me anë të një ankete të strukturur. Gjurmimi finalizohet me raportin perfundimtar dhe siguron informacion të plotë për: nivelin e punësueshmërisë sipas drejtimeve, ndërlidhjen e profesionit me punësimin, nivelin e pagave, vlerësimin retrospektiv mbi programin dhe institucionin etj.

Në kuadër të prezantimit të gjetjeve dhe rezultateve të gjurmimit në nivel kombëtar për të diplomuarit dhe të certifikuarit e AFP, në datën 26 tetor 2023 u zhvillua aktiviteti “Integrimi në tregun e punës për të diplomuarit/certifikuarit e AFP”. Ky takim shërbeu dhe si një hapësirë diskutimi mbi zhvillimet e ndodhura në AFP në funksion të rritjes së cilësisë dhe integritetit të qëndrueshëm në tregun e punës të të diplomuarve dhe certifikuarve.

Aktiviteti 1.3.3.2: Kryerja analizës për nevojat për aftësim nëpërmjet sistemit të parashikimit

Observatori i Tregut të Punës : Instrumenti bazë që do të përdoret për orientimin dhe financimin e politikave pritet të jetë Observatori, i cili do të shërbejë si grumbullues dhe analizues i të gjithë treguesve kryesorë të tregut të punës. Observatori i Tregut të Punës është draftuar në bashkëpunim me UNDP-në dhe është duke u konsoliduar. Observatori aktualisht disponon dhe përpunon të dhëna të gjeneruara nga INSTAT dhe AKPA (të dhëna administrative) duke i shfaqur ato dhe sipas profesionit, gjinisë dhe rajonit. Ky instrument, i cili vazhdon të zhvillohet dhe përmirësohet, parashikon mbledhjen e të dhënave nga institucionet e tjera përkatëse për të krijuar një panoramë të plotë të tregut të punës. Gjithsesi Observatori ende nuk është vënë në administrim të plotë të institucioneve përgjegjëse për punësimin dhe aftësimin pasi pritet të përcaktohen modalitetet e administrimit dhe operimit të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Sistemi i parashikimit të nevojave të aftësive	- Sistemi i parashikimit i zhvilluar/implementuar (deri në vitin 2022) - 3 raporte parashikimi - 4 analiza rajonale të tregut të punës (gjatë 2023, sipas 4 rajoneve) - 12 analiza rajonale të tregut të punës (gjatë 2024, sipas 12 qarqeve)	Në fazë zhvillimi të sistemeve të vlerësimit të nevojave të aftësive

1.3.3 Masa “Vlerësim periodik i nevojave për trajnim”

Institucioni udhëheqës: AIDA

Institucioni kontribues: Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, ministri përgjegjës për ekonominë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, shoqatat e biznesit, dhe sektori privat.

Progresi në zbatimin:

AIDA ka hartuar disa broshura sektoriale për informimin e biznesit si edhe analizuar nevojat për trajnim. Me poshtë gjeni variantin e përditësuar të Factsheets të publikuara:

- Agrikultura: <https://aida.gov.al/publikime/agriculture-factsheet-2024/>
- Turizmi: <https://aida.gov.al/publikime/tourism-factsheet-2024/>
- Manifaktura: <https://aida.gov.al/publikime/manufacture-factsheet-2024/>
- ICT- BPO: <https://aida.gov.al/publikime/ict-bpo-factsheet-2024/>

Përmbledhje

Aktiviteti 1.3.4.1: Dizajnimi i shërbimeve mbështetëse duke përfshirë faqen e internetit, materialet e komunikimit

Broshurat sektoriale

AIDA publikon udhëzues dhe broshura sektoriale në vazhdimësi. Disa nga publikimet e AIDA-s përfshijnë:

- Udhëzues për ndërkombëtarizimin NMVM-ve shqiptare (Certifikimet).
- Një udhëzues i shkurtër mbi pjesëmarrjen në panair/ekspo për NMVM-të shqiptare (për të gjithë panairët/ekspozet pjesëmarrëse).
- Udhëzues për prodhuesit dhe eksportuesit e vajit të ullirit
- Katalogu vjetor i produkteve “Made in Albania”.
- Sillni biznesin tuaj në Shqipëri
- Factsheet për sektorin e turizmit
- Sektori i TIK dhe BPO

- Sektori i prodhimit
- Factsheet për sektorin e bujqësisë, agroturizmit dhe akuakulturës
- Albania Calls; Një vend me mundësi

Ndërkohë, broshurat e mëposhtme sektoriale janë aktualisht njanë aktualisht në process përditësimi me shifrat më të fundit dhe do të zëvendësojnë broshurat aktuale, të botuara në vitin

2023:

- Sektori i tekstilit.
- Sektori i Lëkurës dhe Këpucëve.
- Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
- Sektori i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (BMA).
- Ekonomia Ushqimore – Bujqësi.
- Industria e Ushqimit dhe Pijeve.
- Festivali Global Shqiptar i Gastronomisë/ Expo 2024.

Këto broshura përmbajnë informacion të përmbledhur për sektorët, statistikat kryesore, sfidat e secilit sektor dhe rëndësinë e tyre në ekonomi. Broshurat sektoriale janë subjekt i përditësimeve periodike.

Aktiviteti 1.3.4.2: Ofrimi i shërbimeve mbështetëse dhe kryerja e rregullt e VNT nga një specialist i ANT

Kryerja e rregullt e VNT nga një specialist i ANT

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë shqiptare, dhe trajnimi i duhur është kritik për rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre. Duke konkurruar në një treg të hapur, në praninë e kompanive rajonale dhe ndërkombëtare, NMVM-të shqiptare përballen në mënyrë të vazhdueshme me sfidat për trajnim, mungesa e të cilit ul ndjeshëm konkurrueshmërinë dhe i bën këto ndërmarrje më pak atraktive si në mundësitë e eksportit, ashtu edhe në tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare, AIDA vlerëson periodikisht nevojat e tyre për trajnim nëpërmjet pyetësorëve të publikuar në kanalet e saj të komunikimit për një periudhë një mujore. Mesatarisht, pyetësori plotësohet çdo vit nga 100 – 150 NMVM vendase, përgjigjet e të cilave lejojnë AIDA-n të kryejë një analizë statistikore të nevojave për trajnim.

Nevojat prevaluere në vlerësimet periodike të kryera nga AIDA përfshijnë ato për hartim dhe menaxhim projektsh (80%), menaxhimi financiar (69%), trajnimet menaxheriale (62%), trajnimet e marketingut (66%), si dhe trajnimet për burimet njerëzore (60%).

Gjithashtu, mungesa e aftësive të punonjësit është një shqetësim i vazhdueshëm, por shumica e kompanive i atribuojnë mungesën e trajnimeve në kompanitë e tyre kryesisht mungesës së informacionit të duhur për këto trajnime, si dhe me mungesës së fondeve financiare/buxhetit të dedikuar për trajnime.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË NXITJES SË BIZNESIT

RAPORT MONITORIMI 2021-2024

Nga ana tjetër, AIDA gjithashtu vlerëson në mënyrë të vazhdueshme nevojat për trajnim të stafit, të cilat konsistojnë kryesisht në ngritje kapacitetesh për ekspertiza të ndryshme. Gjatë vitit 2023, stafi i Drejtorisë NMVM & Projekte, dhe stafi i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim – Analizë u trajnuan me mbështetjen e GIZ mbi ngritjen e kapaciteteve për kërkim tregu për qëllime eksporti, si dhe mbi organizimin e workshopeve për subjektet eksportuese.

Indikatorët

Masa	Treguesit e parashikuar	Realizimi
Sistemi i parashikimit të nevojave të aftësive	- Sistemi i parashikimit i zhvilluar/implementuar (deri në vitin 2022) - 3 raporte parashikimi	3 raporte të hartuara



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT



ADRESA
BULEVARDI DËSHMORËT E KOMBIT NR.3, TIRANË
INFO@MEKI.GOV.AL